



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

HULUMTIMI NË VEPRIM

UDHËZIME PRAKTIKE PËR HULUMTIMET NË KLASË

AUTORE

Eda Vula

REDAKTORE

Luljeta Belegu Demjaha

LEKTORE

Vilma Biba

DIZAJNI GRAFIK

projectGRAPHICS

BOTIMI I PARË

Shkurt, 2015

PËRMBAJTJA


| | |
|---|----|
| Mirësevini | 6 |
| Si mund të ju ndihmojë ky doracak? | 7 |
| Ç'është hulumtimi në veprim? | 8 |
| Historik i shkurtër i hulumtimit në veprim | 12 |
| Hulumtimi në veprim dhe zhvillimi profesional i mësimeve | 13 |
| Llojet e hulumtimit në veprim | 14 |
| Ciklet e hulumtimit në veprim | 15 |
| Hapi i parë : Identifikimi i problemit | 19 |
| Si ta formulojmë pyetjen e hulumtimit? | 22 |
| Konteksti teorik | 24 |
| Hapi i dytë: Planifikimi | 27 |
| Hapi i tretë: “Veprimi” dhe mbledhja e të dhënave | 31 |
| Mbledhja e të dhënave - instrumentet | 33 |
| Hapi i katërt: Analiza e të dhënave | 41 |
| Raportimi i të dhënave sasiore duke shfrytëzuar tabelat dhe figurat | 42 |
| Hapi i pestë: Shkrimi i raportit | 49 |
| Literatura | 50 |
| Shtojcat | |
| Shtojca 1: Raporti i hulumtimit të realizuar në kuadër të projektit të BEP: “Hulumtimi në veprim” | 51 |
| Shtojca 2: Mjetet e konkretizimit në mësimin e matematikës | 65 |
| Shtojca 3: Përpilimi i orarit të punës së nxënësve në shtëpi | 78 |

Mirësevini

Hulumtimi në veprim përkufizohet si proces i studimit të situatave në klasë/shkollë për të kuptuar dhe përmirësuar cilësinë e veprimeve apo mësimdhënies. Ideja e lidhjes së termave 'hulumtim' dhe 'veprim' nxjerr në pah funksionin thelbësor të qasjes: përpjekje për të kaluar nga idetë në praktikë. Hulumtimi në veprim paraqet një mjet për përmirësimin dhe rritjen e njohurive në lidhje me kurrikulën, mësimdhënien dhe të nxënit.

Shpesh, hulumtimi në veprim konsiderohet si komponent i zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe reflektim kritik për praktikën e tyre profesionale dhe vlerave arsimore. Ai është hetim sistematik i marrë nga vetë mësimdhënësit me qëllim të sigurimit të një mjedisi efektiv të të nxënit dhe përmirësimit të mësimdhënies.

Hulumtimi në veprim u mundëson mësimdhënësve të lidhin teorinë e mësimimit dhe hulumtimin me praktikat e tyre në klasë dhe u ndihmon atyre të bëhen vetëkritikë, analitikë dhe reflektues. Në përgjithësi, përfitimi nga hulumtimi në veprim është i dyfishtë: përmirësimi i praktikave të mësimdhënies dhe rritja e suksesit të nxënësve.



Si mund të ju ndihmojë ky doracak?

Qëllimi i këtij doracaku është të ndihmojë mësuesin për të kuptuar se ç'është hulumtimi në veprim, si mund të kryhet një hulumtim në veprim dhe nga kush kryhet ai. Në mënyrë specifike, doracaku u ndihmon mësuesve të:

- kuptojnë dhe shpjegojnë përparësitë që ka hulumtimi në veprim;
- demonstron aftësi për të reflektuar rreth praktikës së tyre profesionale në kontekst të përmirësimit të vazhdueshëm dhe në interes të përmirësimit të rezultateve të nxënësve në klasë/shkollë;
- identifikojnë situata/probleme të lidhura me mësuesin, të nxënësve dhe arsimin në përgjithësi;
- demonstron aftësi për planifikimin dhe zhvillimin e një cikli të hulumtimit në klasë/shkollë;
- analizojnë lidhjet midis teorisë dhe praktikës në fushën e arsimit duke vendosur hulumtimin në klasë/shkollë në një kontekst të ndërvarur;
- zhvillojnë projekte të hulumtimit në klasë apo shkollën ku punojnë dhe prezantojnë rezultatet e atij hulumtimi;
- bashkëpunojnë me 'miqtë kritikë' për të reflektuar për vlefshmërinë e hulumtimeve në klasat e tyre.



Reflektoni

Cila është puna juaj si mësues?

Kur diçka nuk shkon mirë në klasën tuaj, çfarë do të bëni?

Ç'është hulumtimi në veprim?

Mësimdhënësit shpesh shqetësohen për probleme të ndryshme që ndodhin në klasat e tyre. Ata shpesh bëjnë pyetje të ndryshme që lidhen me punën e tyre të përditshme:

- *Si ndihen nxënësit e mi kur ballafaqohen me zgjidhjen e problemeve matematikore me fjalë?*
- *A ndikon shfrytëzimi i muzikës si nxitje për të shkruarit kreativ?*
- *Çfarë ndikimi ka integrimi i çështjeve gjinore në kurrikulë për pjesëmarrjen e vajzave në lojërat sportive?*
- *Si të inkurajohen mësimdhënësit për përdorimin e teknologjisë në klasë?*

Kur një ose disa mësimdhënës ndërhyjnë vetë për të bërë ndryshime në praktikat e mësimdhënies dhe njëkohësisht në mënyrë sistematike mbledhin fakte për efektin e atyre ndryshimeve, analizojnë dhe reflektojnë për rezultatet e gjetura, në të vërtetë ata janë marrë me 'hulumtimin në veprim'.

| Përkufizime të hulumtimit në veprim (HV) | |
|---|--|
| Corey (1962) | <i>HV është një proces me të cilin praktikuesit përpiqen të studiojnë problemet e tyre në mënyrë shkencore në mënyrë që të drejtojnë, korrigjojnë dhe vlerësojnë vendimet dhe veprimet e tyre.</i> |
| Kemmis(1998) | <i>HV është një formë e hetimit vetë-reflektues i ndërmarrë nga pjesëmarrësit në situatat shoqërore (klasë/shkollë) për të përmirësuar: (a) praktikat e tyre arsimore; (b) të kuptuarit për këto praktika; (c) situatat në të cilat ato praktika zbatohen.</i> |
| (Stringer, 2004). | <i>HV është një qasje sistematike e hetimit që u mundëson njerëzve të gjejnë zgjidhje efektive për problemet me të cilat përballen në jetën e tyre të përditshme.</i> |
| (Mills, 2011) | <i>HV është çdo hetim sistematik i kryer nga mësimdhënësit- hulumtues, drejtorët, apo hulumtuesit tjerë në mjediset e mësimdhënies/ nxënies për të mbledhur informacion në lidhje me mënyrën se si veprojnë shkollat e tyre të veçanta, si ata mbajnë mësim dhe sa mirë mësojnë nxënësit e tyre.</i> |

Hulumtimi në veprim është:

- Metodë e hulumtimit përmes së cilës hulumtuesi (mësimdhënësi/ja) ndërmerr disa veprime për të zgjidhur një problem.
- Një mënyrë për të lidhur njohuritë e reja me ato ekzistuese.
- Proces të cilin e shfrytëzojnë mësimdhënësit për të zgjidhur probleme në shkollat e tyre.
- Metodë që mësimdhënësit e përdorin për t'i përmirësuar praktikatat e tyre të mësimdhënies.

Sipas Jones McNiff, HV i referohet:

- Një mënyrë të veçantë të hulumtimit të të nxënit;
- Një mënyrë për të shikuar praktikën tuaj, për të kontrolluar nëse ajo është ashtu si ju mendoni se duhet të jetë ...;
- Nëse mendoni se praktika juaj ka nevojë për vëmendje, në një farë mënyre ju do të jeni në gjendje të veproni për të përmirësuar atë, dhe pastaj të paraqitni prova për të treguar se në çfarë mënyre praktika juaj është përmirësuar.

Reflektoni

Si e përkufizoni hulumtimin në veprim?

Cilat janë disa karakteristika të hulumtimit në veprim?

Në përgjithësi, qëllimi i hulumtimeve 'tradicionale' është përgjigjja e pyetjes **"Çfarë po ndodhë këtu?"** ndërsa qëllimi i hulumtimeve në veprim është përgjigjja e pyetjes **"Si mund ta përmirësoj atë që po ndodhë këtu?"**

Procesi i hulumtimit në veprim mund të ndikojë në:

- zhvillimin profesional
- ndryshimet në arsim
- ngritjen e vetëdijes së mësimdhënësve
- përmirësimin e praktikave mësimore dhe dituritë e reja

.. fokusohet në proceset e të nxënit dhe mësimdhënies

... mund të shfrytëzohet për zgjidhjen e problemeve apo marrjen përsipër të ndryshimeve

... mund të shfrytëzohet për të dëshmuar zhvillimin profesional të mësimdhënësve

SHKATHËSITË

Basic Education Program

Përmes punës në grupe, nxënësit zhvillojnë shkathësitë e komunikimit, kreativitetin dhe e pranojnë mendimin e njëri tjetrit. Gjatë punës në grupe ata kuptojnë rolet e tyre në grup. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijen dhe vëtbësimin përmes aktiviteteve konkrete.



të menduarit kritik



vetëvlerësimi



puna grupore



udhëheqësia

KOMPETENCA TË KRËYESORE TË KURRIKULËS SË KOSOVËS

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE TË SHPREHURIT
(Komunikues efektiv)

KOMPETENCA E TË MENDUARIT (Mendimtar kreativ)

KOMPETENCA E TË MËSUARIT (Nxënës i suksesshëm)

KOMPETENCA QË KA TË BËJË ME PUNËN, JETËN DHE MJEDISIN
(Kontribues Produktiv)

KOMPETENCA PERSONALE (Individ i shëndoshë)

KOMPETENCA QYTETARE (Qytetar i përgjegjshëm)



të lexuarit

E SHEKULLIT 21

Ata do të zhvillojnë ndërmarrësi, do të zhvillojnë dhe respektojnë oraret, dorëzimin e projekteve në kohë, do ta mësojnë procesin dhe rezultatet. Përdorimi i pajisjeve të shekullit 21 do t'u ndihmojë nxënësve të përgatiten për jetë dhe punë.

SHKATHËSITË RELEVANTE TË BASIC EDUCATION PROGRAM

LEGJENDA

- të menduarit kritik
- vetëvlerësimi
- puna grupore
- të lexuarit
- TIK-u
- të zgjidhurit e problemit
- kreativiteti
- hulumtimi
- ndërmarrësia
- udhëheqësia
- gjuha e huaj



TIK-u



të zgjidhurit e problemit




kreativiteti



ndërmarrësia



gjuha e huaj




hulumtimi


Historik i shkurtër i hulumtimit në veprim



Termi “hulumtim në veprim” lidhet me punën e **Kurt Lewin** i cili për herë të parë termin në fjalë e përdori në vitin 1946, për të shpjeguar një proces që ndërtohet mbi bazën e ndërthurjes së problemeve praktike, ndërtimit teorik dhe hulumtimit. Lewin e definoi këtë hulumtim si një proces ciklik, dinamik dhe bashkëpunues.



Cikli i Lewin-it



Lawrence Stenhouse (1975, 1983)

MËSIMDHËNËSI-HULUMTUES

Mësuesi është si një kopshtar që trajton bimë të ndryshme në mënyra të ndryshme e jo si një fermer i madh i cili i administron ato në mënyra standarde e me trajtime të standardizuara

Në vitin 1983 **Donald Schön** hulumtimin në veprim e shpjegoi si proces i ndërtimit të njohurive për mbështetjen e praktikave profesionale.

Puna e **David Kolb-it** për ‘Të nxënit nga përvoja’ u mbështet në punën e Lewin dhe Schön

David Hopkins preferon që termin hulumtim në veprim ta zëvendësojë me termin ‘**hulumtimi i mësimit në klasë**’



Hulumtimi në veprim dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Për Watts (1985), hulumtimi në veprim është proces në të cilin pjesëmarrësit **kontrollojnë praktikën** e tyre arsimore me kujdes dhe në mënyrë sistematike; kurse sipas Hamilton (1997) hulumtimi në veprim është 'proces i kërkimeve sistematike brenda mësimitdhënies së vetë-identifikuar apo problemeve të të nxëniet **për të kuptuar më mirë** dinamikën komplekse të saj dhe për të zhvilluar strategjitë që çojnë drejt përmirësimit'.

Pra, ***hulumtimi në veprim*** ndihmon zhvillimin profesional të mësimitdhënësve. Ky hulumtim përdoret për përmirësimin e praktikave mësimore. Ai përfshin veprimin, vlerësimin dhe reflektimin e bazuar në mbledhjen e fakteve dhe zbatimin e ndryshimeve në praktikë.

Hulumtimi në veprim:

- është proces bashkëpunimi; realizohet nga mësimitdhënësit që kanë qëllime të përbashkëta;
- është i bazuar në situata;
- zhvillon të reflektuarit e bazuar në interpretimet e mësimitdhënësve dhe pjesëmarrësve tjerë në hulumtim;
- përkrah dijen që krijohet nëpërmjet veprimit, dhe në kuptim të zbatimit;
- përfshin zgjidhjen e problemeve, nëse ato zgjidhje çojnë në përmirësimin e praktikave arsimore.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Qasja tradicionale
Punëtori dhe takime


Bartje e njohurive nga
"ekspertët"



Hulumtimi në veprim dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve

Hulumtim me bazë në klasë
Mësimitdhënësi/ja-hulumtues/e

Fokusi në **REFLEKTIM** për të nxëniet



Torrance dhe Pryor (2001) kanë treguar se hulumtimi në veprim si qasje e zhvillimit profesional të mësimit shfrytëzohet për të sjellë ndryshime në praktikën e vlerësimit në klasë;

Sipas Hopkins (1985), marrja përsipër e hulumtimit në klasë është një mënyrë që u ndihmon mësimit që me veprimet e tyre të krijojnë një mjedis më energjik dhe më dinamik.

“Hulumtimi në veprim ndikon në krijimin e një kulture për kërkim, rritje vetëbesimit e mësimit dhe i bënë ata të përgjegjshëm për të gjetur rrugë dhe mënyra më të përshtatshme të mësimit” (Vula, 2012)

Llojet e hulumtimit në veprim

Hulumtimet mund të jenë:

- Individuale
- Bashkëpunuese
- Me bazë-në shkollë
- Në nivel komune

| | Hulumtim individual | Hulumtim në veprim bashkëpunues | Hulumtim në veprim në nivel shkollë | Hulumtim në veprim në nivel komune |
|--------------------|---|---|---|---|
| Përqendrimi | Një problem në klasë | Problem në një klasë ose problem i përbashkët në disa klasa | Problem në shkollë që fokusohet në një fushë të interesit të përbashkët | Problem i përbashkët në nivel komune |
| Fushat e interesit | - Kurrikula - Mësimdhënia - Vlerësimi | - Kurrikula - Mësimdhënia - Vlerësimi - Politikat arsimore | - Ristrukturimi dhe ndryshimet në shkollë (Plani zhvillimor i shkollës) - Përfshirja e prindërve - Vlerësimi i programeve | - Aktivitetet e zhvillimit profesional - Strukturat organizative - Politikat arsimore |
| Efekti | Praktika mbështetet në analizën e të dhënave Rezultatet raportohen por jo gjithmonë mund të përgjithësohen | Përmirësim i bashkëpunimit Formim i partneriteteve | Forcimi i bashkëpunimit të ndërsjellë dhe zhvillim i proceseve | Forcimi i bashkëpunimit dhe komunikimit Krijimi i ekipeve me vizion të përbashkët |

Modifikuar nga Themes of Education nga Ferrance

Disa nga fushat ku mund të shfrytëzohet Hulumtimi në Veprim:

1. Metodën e mësimit- zëvendësimi i metodave tradicionale me metodat që përkrahin qasjen me nxënësin në qendër;
2. Strategjitë e të nxënit – përshtatja e qasjes së integruar në vend të të nxënit me bazë –lëndën e veçantë;

3. Vlerësimi – përmirësimi i metodave të vlerësimit;
4. Qëndrimet dhe vlerat – inkurajimi më i madh i qëndrimeve pozitive për punën dhe modifikimi i sistemit të vlerave të nxënësve në lidhje me të nxënësit;
5. Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve në shërbim – përmirësimi i shkathtësive të mësimitdhënësve, zhvillimi i metodave të reja të të nxënësit, rritja e mundësive për një vetëdijësim më të lartë;
6. Menaxhimi dhe kontrolli – paraqitje shkallë- shkallë e teknikave të dobishme të menaxhimit;
7. Administrimi – rritja e efikasitetit të disa aspekteve në lidhje me jetën e shkollës.


Ciklet e hulumtimit në veprim

Stephen Kemmis ka zhvilluar një model të thjeshtë të ciklit me katër hapa: **planifiko, vepro, vëzhgo dhe reflekto**.

Për pyetjen kryesore:

“Si mund t’u ndihmoj nxënësve për të përmirësuar të nxënësit e tyre?”, i formulojmë pyetjet specifike sipas modelit të Kemmi-së:

1. Cilat janë shqetësimet gjatë punës sime në klasë?
2. Çfarë mund të bëj në lidhje me to?
3. Çfarë fakte më ndihmojnë të gjykoj për atë që bëj?
4. Si do t’i provoj “gjykimet” për ato që i kam bërë?



Problemi i hulumtimit

Reflektoni

Reflektoni mbi atë që ka ndodhur për t’u përmirësuar më tej veprimet...

Planifikoni ...

Planifikoni se çfarë duhet bërë...

Vëzhgoni ...

Vëzhgoni, monitoroni dhe regjistroni...

Veproni ...

Zbatoni planin, mbledhni të dhënat...

Ciklet sipas Richard Sagor:

1. Qartësimi i vizionit/qëllimit tuaj (përcaktimi se çfarë doni të shihni - rezultate të pritura të sakta);
2. Shpjegimi i teorisë tuaj (planifikimi i mënyrës më të mirë për të arritur rezultatet);
3. Zbatimi i teorisë tuaj (plani i veprimit dhe mbledhja e të dhënave);
4. Reflektim për rezultatet (shqyrtimi i të dhënave për të parë se çfarë tregojnë ato dhe të vendoset se si të veprohet mbi bazën e atyre rezultateve).

Reflektoni

Përshkruani ciklet e HV me fjalët tuaja?

Pse HV është proces ciklik e jo proces një kahësh?

Ciklet e hulumtimit në veprim

Sipas Johnson (2008), hulumtimi në veprim përfshin pesë hapa kryesorë. Së pari identifikohet problemi ose përkufizohet fusha që duam ta shqyrtojmë dhe përcaktohet se çfarë dëshirojmë të shqyrtojmë. Së dyti, vendoset se çfarë të dhënash dëshirojmë t'i mbledhim, si do t'i mbledhim dhe sa herë do t'i mbledhim ato. Së treti, mblidhen dhe analizohen të dhënat. Së katërti, përshkruhet si mund të shfrytëzohen dhe të zbatohen rezultatet e gjetura. Në këtë fazë, hartohet një plan i veprimit i bazuar në gjetjet dhe në fund, shkruhet raporti dhe rezultatet diskutohen dhe ndahen me të tjerët.

Në ciklin e paraqitur, sipas Johnson, hulumtimi në veprim është proces "kthyes" e jo proces që zhvillohet në mënyrë lineare. Shpeshherë, mësimdhënësit hulumtues e përsërisin ndonjë hap të këtij cikli ose i realizojnë hapat me ndonjë renditje tjetër. Poashtu, në ndonjë projekt të hulumtimit në veprim mund të kërkohet edhe hapi i gjashtë, që në të vërtetë i vendosë rezultatet apo pyetjen/et e hulumtimit në kontekstin teorik. Ky hap njihet si *shqyrtimi i literaturës*.



Hapat e procesit të hulumtimit në veprim

Planifikimi i hulumtimit në veprim/në klasë, sipas Prof. Townsend (Skyyt, 2000)

Planifikimi i hulumtimit në veprim/në klasë, sipas Prof. Townsend (Skyyt, 2000)

1. Përkufizoni problemin

Bëni pyetje të drejta
Filloni me reflektimin.

2. Mblidhni të dhënat

Lexoni literaturë, konsultoni kolegët, bisedoni me ekspertë;
Vazhdoni me reflektimin
Paraqitni kuptimin e informacioneve
Çfarë është relevante?
Çfarë mund të bëhet?
Çfarë mund të modifikohet dhe të përshtatet me rrethanat e reja?

4. Përdorni informacionin

Ndani përfundimet paraprake me grupin
Përgatituni për t'u marrë me informacione kontradiktore

5. Planifikoni veprimin

Ndani qëllimet individuale me anëtarët e ekipit
Ndërtoni planin e angazhimit personal
Zhvilloni një plan të veprimit

6. Filloni të veproni

Filloni të vendosni planin tuaj në veprim
Filloni të mendoni ndryshe për atë që po ndodhë dhe pse;
Reflektimi për veprimet e bënë përpjekjen tuaj të qëllimshme

7. Mblidhni të dhënat

Mblidhni të dhënat për t'iu përgjigjur pyetjes së hulumtimit dhe dokumentoni me kujdes ato
Takohuni rregullisht me kolegët dhe bashkëpunëtorët për të shkëmbyer përvojat,

8. Analizoni të dhënat

Shfrytëzoni njohuritë e përgjithshme për të kuptuar se çfarë po ndodhë dhe pse.
Krahasoni të dhënat para dhe pas fillimit të procesit hulumtues

9. Vlerësoni të arriturat tuaja

Mendoni për provat e bazuara në praktikë
Përfundimet tuaja i mbështetni në të dhënat e mbledhura

10. Publikoni

Përkushtohuni në punën tuaj për të bërë përfundime në lidhje me ndikimin e përpjekjeve tuaja.
Ndani këto përfundime me të tjerët.
Përgatituni për të shpërndarë raportin tuaj në shkollën tuaj dhe grupin tuaj

11. Plani i ardhshëm (Reflektoni)

Lejoni vetes kohë për të konsoliduar të nxënit tuaj para se të filloni diçka të re.



HAPI I PARË: IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT

Filloni me pyetjen, "Çfarë më shqetëson në klasën time? Shqetësimi juaj duhet të lidhet me punën tuaj dhe mënyrën si mësojnë nxënësit. Ai duhet të jetë një shqetësim për të cilin ju vetë duhet të bëni diçka dhe të gjeni zgjidhje për ta tejkaluar atë. Diskutoni me kolegët se ndoshta me të njëjtin shqetësim përballen edhe ata/ato.

Janë disa pyetje tjera që ndihmojnë në procesin e identifikimit të problemit: Çfarë po ndodhë tani? Në ç'kuptim është problematike kjo që po ndodhë? Çfarë mund të bëj unë për këtë?... Do të dëshiroja të përmirësoj Disa nuk janë të kënaqur me.... Çfarë mund të bëj për ta ndryshuar situatën? Unë jam i/e shqetësuar për ; Kam një ide të cilën duhet ta provoj në klasën time....

Mësimi në klasat e kombinuara është mjaft i vështirë. Si mësimdhënës më shqetësonte fakti se nxënësit shpesh ishin të shpërqendruar gjatë orëve të mësimi. Në kokën time vlonin pyetje të ndryshme përkitazi me këtë çështje, si:

- A duhet që nxënësit e dy klasave dhe moshave të ndryshme të mësojnë në një dhomë mësimi?
- Sa janë të përqendruar nxënësit e moshave të ndryshme të dy klasave në temat të cilat i zhvillon mësimdhënësi në një dhomë mësimi?
- Cilat janë shkaqet e shpërqendrimit të nxënësve në orët mësimore në klasat e kombinuara?
- Cilat teknika janë më të përshtatshme për punë me këtë lloj mësimi?
- Si të planifikoj më mirë mësimdhënien time me nxënës të klasës së kombinuar?

Rifati- mësimdhënës



Reflektimi për çështjet e shënuara në tabelën e mëposhtme ju ndihmon të hetoni shqetësimin tuaj fillestar dhe identifikimin e një problemi në klasë ose në një fushë të caktuar.

Parashtrimi i problemit ka të bëjë në mënyrë të veçantë me nxënësit tuaj, prandaj jepni sa më shumë informacione për shkaqet që mbështesin problemin, qëllimin për përmirësim dhe çfarë mund të bëhet për zgjidhjen e tij.

Aktualisht në klasën time jam i/e shqetësuar për...

Për të shqyrtuar shqetësimin tim, më duhet të mbledh informacione për...

Informacionet e nevojshme do t'i marr nga këto burime të dhënash...

Për të plotësuar nevojat e nxënësve, më duhet ta fokusoj mësimdhënien time në...

Shembull:**Përpilimi i orarit të punës së nxënësve në shtëpi**
Edi Gaxha Puka

Një ndër problemet më të shpeshta për të cilin brengosen prindërit dhe mësuesit është mungesa e shprehisë së punës tek nxënësit.

Të mësuarit e përditshëm dhe orari i obligimeve ditore krijojnë ndjenjën e vetdisiplinës të nxënësit. Njohja e obligimeve të tyre dhe mundësitë për të kontrolluar kryerjen e këtyre obligimeve krijojnë shprehje të punës së nxënësit. Detyra ime profesionale, si mësues është të veproj rreth kësaj çështjeje me shumë përkushtim dhe kujdes.

Duke qenë çdo ditë pranë fëmijëve, vërej pasojat të cilat i sjell mungesa e shprehisë së punës.

Si të nxisim interesim të natyrshëm te fëmijët që të mësojnë në shtëpi sistematikisht dhe me orar të caktuar?

Si të krijojmë te nxënësit vetdisiplinën?

Sa mund të bashkëpunojmë me prindërit për t'i avancuar fëmijët në këtë drejtim?

Çfarë kushte duhet t'u sigurojmë fëmijëve që të mësojnë vazhdimisht dhe me produktivitet?

Janë këto disa pyetje që shprehin shqetësimin tim si mësues dhe më nxisin ta realizoj këtë punim. Pasi shqyrtova me kujdes literaturën e vendeve të ndryshme, vendosa ta realizoj këtë hulumtim. Përmes këtij hulumtimi në veprim synoj të gjej e vlerësoj mënyrat e ndryshme të cilat motivojnë nxënësit të punojnë me plan dhe të krijojnë shprehje të punës.



Si ta formulojmë pyetjen e hulumtimit?

Kur zgjedhet tema për hulumtimin në klasë, fillimisht duhet siguruar që së paku në fillim ajo të jetë praktike, e veçantë dhe interesante. Kështu, pas identifikimit të një problemi të caktuar dhe përcaktimit të qartë se cilat çështje dhe ngjarje janë të lidhura me atë problem, hulumtuesit fokusohen në formulimin e pyetjes hulumtuese dhe objektivave të studimit.

| Formuloni PYETJEN e HULUMTIMIT | |
|---|--|
| 1. Identifikoni problemin (Bisedoni me kolegët apo 'miqtë kritikë') | Problemi: |
| 2. Pse ka ndodhur problemi? | Renditni disa arsye: a) b) c) ... |
| 3. Paraqitni disa veprime të mundshme | Renditni disa mundesi: a) b) c) ... |
| 4. Shkruani pyetjen tuaj të hulumtimit | Nëse do të _____ (shkruani veprimin) a do të _____ (shkruani problemin)? |

Modifikuar nga Hollingsworth et al, 2005

Shembuj të pyetjeve hulumtuese, disa në formë të hipotezës e disa të lidhur me çështje specifike:

- Si mund ta përmirësoj komunikimin tim me prindërit?
- Si ndjehen nxënësit e mi kur ballafaqohen me zgjidhjen e problemeve matematikore me fjalë?
- Shfrytëzimi i punës në grup ndikon pozitivisht në inkurajimin e nxënësve për të shprehur kreativitetin e tyre;
- Shfrytëzimi i muzikës si nxitje për të shkruarit kreativ. Cilat janë rezultatet?
- Çfarë ndikimi ka integrimi i çështjeve gjinore në kurrikulë për pjesëmarrjen e vajzave në lojërat sportive?
- Rritja e suksesit të nxënësve varet nga shfrytëzimi i teknologjisë në klasë?!

Shembull i formulimit të **PYETJES së HULUMTIMIT** përshtatur nga hulumtimi i realizuar nga mësimdhënësja Rajmonda Kurshumlia dhe Blerina Haraqija:

INTERESIMI I NXËNËSVE NË LEXIMIN E LEKTURËS SHKOLLORE

| | |
|--|--|
| <p>1. Identifikoni problemin (Bisedoni me koleget 'miqtë kritikë')</p> | <p>Problemi: Nxënësit nuk përfshihen në mënyrë aktive në leximin e lektyrave¹</p> |
| <p>2. Pse ka ndodhur problemi?</p> | <p>Renditni disa arsye: a) Nxënësit nuk janë të interesuar b) Nxënësit nuk pëlqejnë të lexojnë gjithmonë lektyrat që u rekomandohen nga mësimdhënësit c) Nxënësit nuk nxiten të lexojnë në shkollë dhe shtëpi</p> |
| <p>3. Paraqitni disa veprime të mundshme</p> | <p>Renditni disa mundesi: a) Përzgjedhja e lirë e lektyrave nga nxënësit b) Përshkrimi i karakteristikave kryesore të librit c) Krijimi i bibliotekës së klasës</p> |
| <p>4. Shkruani pyetjen tuaj të hulumtimit</p> | <p>Si mund të ndikojë përzgjedhja e lektyrave të përshtatshme dhe në përputhje me interesimet dhe kureshtjen e nxënësve në motivimin e tyre për lexim?</p> |



Përzgjedhja e lektyrës nga nxënësit sipas intersimeve të tyre



Biblioteka e klasës

¹ Projekti hulumtues i realizuar nga mësimdhënësja Rajmonda Kurshumlia dhe Blerina Haraqija

KONTEKSTI TEORIK

Para se të filloni me hartimin e planeve të veprimit, shqyrtoni me kujdes literaturën që lidhet me problemin tuaj hulumtues.

Shqyrtimi i literaturës

- Ju ndihmon të identifikoni se çfarë është bërë më parë në lidhje me çështjet që ju interesojnë;
- Ju ndihmon të zhvilloni të kuptuarit konceptual për temën tuaj;
- Ju ndihmon të zhvilloni fjalorin akademik;
- Ju mbështet në përmirësimin e pyetjes apo hipotezës së hulumtimit tuaj;
- Ju ofron informacione të nevojshme për të arsyetuar rëndësinë e hulumtimit tuaj;
- Ju mundëson të merrni për bazë të dhënat dhe pikëpamjet e ndryshme;
- Ju ndihmon të analizoni rezultatet dhe t'i diskutoni ato me rigorozitet.

Reflektoni

Bisedoni me mësimdhënës tjerë/kolegë në lidhje me pyetjen e hulumtimit për të parë se si ata reagojnë dhe u kërkoni atyre të japin sugjerime

Shqyrtoni artikuj të ndryshëm dhe burime nga interneti që lidhen me problemin tuaj të hulumtimit

Burimet për shqyrtim të literaturës:

Revistat shkencore - janë burimet kryesore për shqyrtimin e literaturës. Ato përmbajnë artikuj të shkruara nga hulumtues në fusha të caktuara të cilat paraprakisht rishikohen nga një numër ekspertësh për vlefshmërinë dhe besueshmërinë.

Interneti – është një burim shumë i mirë për të gjetur shumë shpejtë informata të nevojshme. Megjithatë, shpesh informatat e tilla nuk janë të besueshme sikur ato që i gjejmë te revistat shkencore. Një prej faqeve më të besueshme që mund të përdoren për fushën e edukimit është ERIC (Educational Resources Information Center), www.eric.ed.gov.

Librat – janë burime mjaft të besueshme. Por, duhet të keni parasysh se informatat që i gjeni të shtypura në libra të ndryshëm, jo gjithmonë janë të vërteta. Prandaj, duhet të zgjedhni libra që citojnë autorë dhe burime të vlefshme dhe të cilat botohen nga shtëpi botuese të besueshme.

Burime tjera, si raporte të mësimdhënësve tjerë, kurrikulat, të dhëna për fëmijët që merren nga prindërit e tyre, apo shënime që i mbledhni gjatë punës suaj.

Shembull:

Shqyrtimi i literaturës në projektin

“INTERESIMI I NXËNËSVE NË LEXIMIN E LEKTURËS SHKOLLORE”

Studiues të ndryshëm kanë realizuar punime dhe hulumtime lidhur me motivimin e nxënësve për leximin e librave. Autorja Linda Gambrell në punimin e saj “Creating classroom cultures that foster reading motivation” thekson mundësinë për motivimin e nxënësve për të lexuar libra. Ajo thekson disa mënyra për të përforcuar këtë motivim: mësimdhënësit si model leximi, krijimi i ambientit të pasur me libra në klasë, mundësi për zgjedhje të librave, vetëzgjedhja e librave nga nxënësit etj. “Janë katër faktorë kyç për të motivuar nxënësit për të lexuar libra: qasja në libra në klasë, mundësitë për të zgjedhur libra vetë, njohja me libra dhe ndërveprimet sociale me të tjerë rreth librave.”(Gambrell, 1996, f.20)

Problemin e motivimit të nxënësve për të lexuar libra e kanë trajtuar në hulumtimin e tyre edhe autoret Kethryn Edmunds dhe Kethryn Bauserman. Në hulumtimin e tyre, autoret janë bazuar kryesisht në të dhënat të cilat i kanë marrë nga intervistat me nxënës, përmes të cilave kanë kuptuar se nxënësit zgjedhin për të lexuar libra të cilët u përshtaten interesave të tyre personale. Poashtu ka pasur rëndësi edhe përzgjedhja e librave, ku nxënësit për të diskutuar rreth librave preferojnë librat e zgjedhur vetë e jo librat e caktuar nga mësimdhënësit. Pra, nxënësit janë të motivuar për të lexuar kur t’u jepet mundësia se çfarë të lexojnë. Autoret japin pesë rekomandime për motivimin për lexim: “vetëzgjedhja, vëmendja në karakteristikat e librit, interesat personal, qasja në libra dhe përfshirja aktive e të tjerëve”(Edmunds & Bauserman, 2006, f.423).

Rëndësinë e interesave të nxënësve për leximin e librave dhe sigurimin e librave në përputhje me interesimin e nxënësve e thekson edhe Kauffman (2005) në punimin studimor *Story elements which impact children reading interes*. Duke ditur interesat e nxënësve për lexim dhe duke ndihmuar ata në përzgjedhjen e librave që përputhen me kureshtjen e tyre do t’i ndihmojmë që të bëhen lexues gjatë tërë jetës.

Në punimin e tyre studimor lidhur me motivimin për lexim, autorët Gambrell, Palmer, Codling dhe Mazzoni (1996) kanë përdorur anketa dhe intervista për të kuptuar natyrën individuale të nxënësve, motivimin për lexim, librat më ineresantë, autorët favoritë dhe mënyrat si i gjejnë nxënësit librat. Intervista është mënyrë shumë e mirë për të kuptuar çfarë duan nxënësit.

Ajo që rezulton si kryesore në pjesën më të madhe të hulumtimeve të cilat i kemi lexuar është pikërisht përshtatja e librave të zgjedhur me interesat personale të nxënësve. Nxënësve, sipas këtyre studimeve, duhet krijuar mundësi për vetëzgjedhje të librave dhe në përputhje me interesimet e tyre. “Interesi është faktor i rëndësishëm në zgjedhjen e librave nga nxënësit, shumë nxënës zgjedhin libra të veçantë për të lexuar sepse aty ka diçka interesante për ata”(Kauffman, 2005, f.26).

Përveç interesave të nxënësve, në motivimin për lexim autorët theksojnë edhe rolin e mësimdhënësit si model motivimi. Një nga faktorët kryesor në motivimin e nxënësve për të lexuar është edhe mësimdhënësi i cili vlerëson të lexuarit dhe është entuziast për të ndarë dashurinë për leximin me nxënësit (Gambrell, 1996, f.20). Entuziazmi për libër vjen sepse mësimdhënësi është i prirur për të ndarë atë, apo shkon drejt rrugës për ta bërë përvojë të pasur për klasën. (Doiron, R. 2003, f.44)

Shqyrtimi i hulumtimeve të realizuara dhe gjetjet e tyre kanë qenë mbështetje në punën tonë hulumtuese.



9.3

9.6

9.7

9.9

9.10

9.8

9.5

9.2

9.1

9.4

8.07

HAPI I DYTË: PLANIFIKIMI

Pas identifikimit të problemit, hartimit të pyetjes së hulumtimit dhe sigurimit të informacioneve shtesë në lidhje me çështjen që hulumtohet zhvillohet plani i veprimit. Ky plan duhet të përfshijë të dhëna specifike për pjesëmarrësit, strategjitë, burimet e nevojshme, procedurat e vlerësimit dhe kohën për zbatimin e të gjitha hapave. Pyetjet e mëposhtme ju ndihmojnë për një planifikim të mirëfilltë:

- Çfarë po ndodhë aktualisht në fushën për të cilën dëshiroj të hulumtoj?
- Cilat janë pritjet e mija nga ky projekt?
- Kush do të jenë pjesëmarrës në hulumtimin tim?
- Ku do të zhvillohet hulumtimi?
- Çfarë informata shtesë më duhen?
- A mund të siguroj burimet që më nevojiten?
- Sa kohë më nevojitet për të zbatuar veprimet e planifikuara?


Çfarë pritet nga planifikimi?

- *Formulim i qartë i planit të veprimit i cili përfshin mënyrën e drejtimit të pyetjes suaj të hulumtimit;*
- *Zhvillimi i parimeve etike dhe jetësimi i tyre në praktikë;*
- *Gatishmëria për të bashkëpunuar me të tjerët dhe modifikimi i planit të veprimit mbi bazën e diskutimeve 'kritike';*
- *Identifikimi i mundshëm i çështjeve që kundërshtojnë vlerat e paraqitura dhe mënyra e zgjidhjes së atyre situatave.*

Shembull 1:

Planifikimi i hulumtimit bashkëpunues 'Puna shtesë me fëmijët e talentuar në lëndën e matematikës' nga **Njomza Kelmendi dhe Jetmira Xërxa**

Për realizimin e hulumtimit tonë, fillimisht është bërë konsultimi me literaturën e nevojshme dhe të përshtatshme për punën me fëmijët e talentuar në matematikë. Më pas, është bërë mbledhja e materialit dhe modifikimi i tyre për ta përshtatur për nevojat e klasëve tona.



Hapat kryesor që ne i parashikojmë për hulumtim janë: vëzhgimi sistematik në klasë, lista e kontrollit, pyetësorët me prindër, mësimi shtues dhe testimi përmbljedhës.

Tab.1. Lista e kontrollit për identifikimin e nxënësve të talentuar

| Nxënësi/-ja: | | | | |
|---|------------|------------|------------|---------|
| Shpeshësia | Rrallëherë | Ndonjëherë | Shpeshherë | Komente |
| I pëlqen të merret ose të luaj me numrat | | | | |
| I pëlqen të merret ose të luaj me numrat | | | | |
| I pëlqen të merret me eksperimentin në klasë | | | | |
| Arrin të zgjidhë detyra sfiduese | | | | |
| Bënë pyetje të ndryshme duke insistuar që të merr përgjigje. | | | | |
| i kupton shembujt logjikë dhe marrëdhëniet | | | | |
| I transferon veprimet matematikore në detyra të jetës së përditshme | | | | |
| ***** | | | | |

Shembull 2:

Ndikimi i leximit me zë në aftësimin e nxënësve të klasës së parë për lexim-kuptim
Luljeta Rama

Pyetja e hulumtimit: Si do të ndikojë leximi me zë në tejkalimin e vështirësive në lexim –kuptim te nxënësit e klasës së parë?

Planifikimi i hulumtimit

Për të pacaktuar qartë se ku qëndron problemi unë kam vendosur që si **plan të parë** :

- të përdor një pyetësor për prindër për të parë se sa lexojnë bashkë me fëmijë;
- të përdor testin e modifikuar të bazuar në testin EGRA, i cili ka të bëjë me njohjen e emrit të shkronjës/tingullit dhe me leximin e fjalëve të njohura;
- dhe pas analizës së të dhënave të futura, të hartoj planin për veprim me nxënësit e testuar

Plani i dytë i veprimit:

- zgjedhja e librave të përshtatshëm për përdorimin e teknikës së Leximit me Zë si librat e punuar me nivele nga programi i BEP/USAID
- leximi i së paku dy librave në javë brenda në klasë me teknikën e Leximit me Zë
- informimi i prindërve të nxënësve të testuar, për hapat e teknikes së Leximit me Zë
- bisedimi me prindërit që edhe ata t’u lexojnë me zë fëmijëve në shtëpi së paku dy libra sipas dëshirës së fëmijës, dhe
- pas tri javësh, të përsëris testimin për të vërtetuar nëse ka përmirësim në aftësinë e lexim - kuptimit

Plani i tretë i veprimit:

Si libër të parë kam përdorur librin “ Vitaminat” dhe pastaj librin tjetër javën e dytë “Pepa dhe trofeu” të cilët i kam përdorur gjatë orës së mësimi zgjedhor. Për ta zbatuar teknikën e Leximit me zë jam bazuar në manualin për lexim- kuptim të përgatitur nga programi BEP.

Shembull 3:

Projekti: **Vetëdijesimi i nxënësve për ruajtjen e mjedisit**

Majlinda Muja dhe Ilirjana Ademaj

Planifikimi:

| Grafiku i zbatimit të planit | | | |
|--|--|------------|---------------|
| Lloji i të dhënave | Si janë mbledhur | Sa? | Data |
| Pyetësorët për grupin e ekologëve | Janë shpërndarë gjatë takimit me ta | 18 | 25 maj |
| Trajnimi nga eksperti i fushës | Trajnim në shkollë | 18 nxënës | 27 maj |
| Esetë | I kanë shkruar në shtëpi | 18 ese | 30 maj |
| Aksioni për pastrim | Grupi i ekologëve kanë pastruar oborrin e shkollës | 26 persona | 3 qershor |
| Pyetësori për mësimdhënës | Janë shpërndarë në shkollë | 5 | 10 qershor |
| Përgatitja e grupit të ekologëve për trajnim | Takime në shkollë | | 10-13 qershor |
| Përgatitja e pyetësorit nga grupi i ekologëve për bashkëmoshatarët | Takime me grupin e ekologëve në shkollë | 18 nxënës | 13 qershor |
| Trajnimi nga grupi i ekologëve | Prezantime nëpër klasa | 115 nxënës | |

| | | | | | |
|----|----|----|----|----|-----|
| 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 10 | 12 | 14 | 16 | 18 | 20 |
| 15 | 18 | 21 | 24 | 27 | 30 |
| 20 | 24 | 28 | 32 | 36 | 40 |
| 25 | 30 | 35 | 40 | 45 | 50 |
| 30 | 36 | 42 | 48 | 54 | 60 |
| 35 | 42 | 49 | 56 | 63 | 70 |
| 40 | 48 | 56 | 64 | 72 | 80 |
| 45 | 54 | 63 | 72 | 81 | 90 |
| 50 | 60 | 70 | 80 | 90 | 100 |



HAPI I TRETË: “VEPRIMI” DHE Mbledhja e të dhënave

Në fazën kur zbatohet plani i veprimit mbledhni të dhënat para, gjatë dhe pas zbatimit të një qasjeje të re. Vendosni se si do të dëshmoni kushtet ekzistuese dhe ndryshimet e atyre kushteve pas zbatimit të “qasjes” së re. Mblidhni të dhënat, analizoni dhe mësoni nga ato. Mbledhja e të dhënave është një hap i rëndësishëm në marrjen e vendimeve se çfarë duhet ndryshuar. Prandaj, për të kuptuar më mirë qëllimin e aktiviteteve në klasë ose në shkollë, përdoren burime të shumta të të dhënave.

| Të dhënat sasiore | Të dhënat cilësore |
|--|---|
| <p>Merren me numrat</p> <p>Të dhënat mund të maten:</p> <p>Dimensionet, shpejtësia, koha, mosha, numërimi i ngjarjeve dhe objekteve etj</p> <p>Shembuj për të dhënat numerike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezultatet e testeve të nxënësve në klasë; - Testet e standardizuara; - Shënimet administrative në lidhje me numrin e nxënësve; - Shënimet për përbërjen e stafit dhe nxënësve në aspektin gjinor, të moshës, apo ndonjë aspekti tjetër; - Informatat në lidhje me pajisjet e shkollës, materialet dhe burimet tjera; <p>Raportet zyrtare që lidhen me braktisjen e shkollës apo gjendjen e bibliotekave dhe laboratorëve</p> | <p>Merren me përshkrimin</p> <p>Të dhënat mund të vëzhgohen por jo të maten:</p> <p>Ndjenjat, qëndrimet, forma, motivimi etj.</p> <p>Shembuj për të dhënat cilësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Qëndrimet e nxënësve në lidhje me përdorimin e teknologjisë në klasë; - Sjelljet e nxënësve në klasë; - Motivimi për të lexuar lektura shkollore; - Bashkëbisedimet në klasë; - Vizatime apo paraqitje tjera vizuale të nxënësve; - Shënime në ditarë; |





Të dhënat: cilësore apo sasiore?

Lista e pyetjeve para procesit të mbledhjes së të dhënave

- Cilat të dhëna do të mblidhen?
- Kush do të mbledhë të dhënat - ju, vëzhguesi/et, kolegët apo pjesëmarrës tjerë?
- A janë marrë parasysh çështjet etike?
- A u keni marrë 'leje' atyre që do të përfshihen në projektin hulumtues, si për shembull leje nga prindërit, kolegët apo udhëheqësi/ja e shkollës?
- A i keni kontrolluar të gjitha pajisjet që do të shfrytëzohen gjatë hulumtimit? A janë në gjendje të rregullt flip-kamerat, telefonat e mençur apo pajisjet tjera të nevojshme?
- A është menduar se si do të vërtetohet saktësia, besueshmëria dhe përshatshmëria e informacioneve?
- Ku dhe si do të mblidhen të dhënat?
- A keni një ide të përgjithshme se si do të analizohen të dhënat?
- A i keni organizuar burimet e nevojshme, duke përfshirë edhe shpenzimet?

Plani i mbledhjes së të dhënave

- **PSE po i mbledhim këto të dhëna?**
- **ÇFARË saktësisht do të mbledhim?**
- **CILAT janë temat?**
- **KU do të mblidhen të dhënat?**
- **KUR do t'i mbledhim të dhënat?**
- **KUSH do t'i mbledhë të dhënat?**
- **SI do t'i mbledhim të dhënat?**

Mbledhja e të dhënave - Instrumentet

Mjete hulumtimi (instrumente) quhen procedurat (mënyrat) për mbledhjen e të dhënave.

Si i mbledhim të dhënat ?

Pyetësorët

- Vendosni se çfarë informata dëshironi të fitoni;
- Siguroni që pyetësi të jetë i thjeshtë.
- Merrni parasysh metodat e analizës së pyetjeve para se ato të hartohen;
- Zakonisht, pyetësorët i filloni me pyetje në lidhje me faktet;
- Përdorni gjuhë të thjeshtë
- Siguroni se formulimi i pyetjeve është i qartë dhe nuk ka vend për interpretime të dyfishta;
- Nuk duhet të përfshihen dy çështje në një pyetje (A duhet të qëndrojnë fëmijët në shkollë gjatë kohës së drekës dhe pas mësimi?)
- Mundohuni që pyetjet të jenë të përshtatura në aspektin pozitiv, e jo në atë negativ;
- Pyetjet duhet të jenë të shkurtra dhe të mos përmbajnë zhargone me të cilat pjesëmarrësit janë jo të familjarizuar;

Intervistat

Për hulumtimet në klasë, intervistat shërbejnë për:

- Fokusimin në një aspekt të veçantë të mësimdhënies apo ndonjë problem në klasë;
- Sigurimin e informacioneve të përgjithshme diagnostikuese nëpërmjet diskutimit të mësimdhënësit dhe nxënësve;
- Përmirësimin e klimës në klasë

Dokumentet dhe materialet tjera: Planet mësimore, syllabuset, kurrikula, baza e të dhënave, projektet, testet, raportet e hulumtimeve, orare, të dhëna për arritshmëri, legjislacioni, portfolio, rregullat dhe rregulloret, procedurat, raportet vjetore etj

Vëzhgimi në klasë fokusohet në:

- *Njerëzit:* nxënësit, mësimdhënësit, administratorët, prindërit, etj
- *Vendet:* klasa, fusha e sportit, zyra, shtëpia, kabinetet, laboratorët etj
- *Veprimet:* veprimet e thjeshta që bëjnë njerëzit (një nxënës fshin me gomë...)
- *Aktivitetet:* bashkësia e disa veprimeve (p.sh. të shkruarit e një eseje...)
- *Ngjarjet:* bashkësia e lidhjes së aktiviteteve (p.sh. ora e artit figurativ...)
- *Objektet:* ndërtesa, pajisjet, mobilet, librat dhe materialet ndihmëse për të nxënësit,
- *Qëllimet:* çfarë duan të arrijnë nxënësit dhe mësimdhënësit;
- *Koha:* periudhat, shpeshësia, kohëzgjatja dhe sekuencat e ngjarjeve dhe aktiviteteve,
- *Ndjenjat:* orientimet emocionale dhe reagimet e nxënësve ndaj ngjarjeve, aktiviteteve etj.

| | Instrumentet e mbledhjes së të dhënave | Përkufizimi | Qëllimi |
|----------------|---|---|---|
| Duke PYETUR | Intervistat | Hulumtuesi pyet një person për të marrë përshtypjet e tij për atë që ndodhë dhe përgjigjet në pyetjet e shtruara | Të merren sa më shumë informacione për qëndrimet, besimet dhe idetë e një personi |
| | Fokus grupet | Hulumtimi i pyet disa njerëz (4 deri në 6) për idetë e tyre rreth një çështje të caktuar | Të merren sa më shumë informacione për qëndrimet, besimet dhe idetë e një grupi njerëzish |
| | Pyetësorët | Hulumtuesi u bën disa pyetje shumë njerëzve. Pyetjet mund të jenë të hapura apo të mbyllura- dhe përgjigjet, në të shumtën e rasteve, jepen me shkrim | Te mblidhet informacion nga një grup i madh i njerëzve |
| Duke SHIKUAR | Vëzhgimet | Hulumtuesi vrojton njerëzit, (mësimdhënësit, nxënësit ose vetveten) ngjarjet apo situatat dhe regjistron çfarë shikon dhe dëgjon. | Të vrojtojhet mënyra se si sjellen njerëzit në situata të caktuara |
| | Kujtesat / ditarët | Hulumtuesi regjistron idetë dhe vëzhgimet kohë pas kohe në lidhje me veprimet e caktuara | Të regjistrohet sistematikisht çfarë ndodhë në klasë apo në mjedisin e hulumtimit |
| Duke SHQYRTUAR | Punimet e nxënësve | Hulumtuesi shqyrton punimet e nxënësve si, detyrat e shtëpisë, portfoliot, projektet, esetë etj. | Të shikohet se si nxënësit mund (ose jo) të demonstrojnë njohuritë e tyre dhe shkathtësitë për ato që kanë mësuar |
| | Rezultatet numerike (të testeve, notat etj) | Hulumtuesi shqyrton informatat që zakonisht janë të regjistruara si numra (rezultatet e testeve, numrin e nxënësve etj. | Të krahasohen/analizohen rezultatet e nxënësve sipas kriterëve të caktuara ose sipas grupeve të caktuara |
| Duke LEXUAR | Shqyrtimi i literaturës | Hulumtuesi lexon dokumente të shkruara nga hulumtuesit tjerë apo nga mësimdhënësit që janë të botuara në libra, gazeta profesionale, gazeta shkencore apo sajte të internetit | Të kuptojë më mirë fushën e studimit, për të gjetur zgjidhje të mundshme dhe ide për çështjen e veçantë |
| | Shqyrtimi i dokumenteve / politikave arsimore | Hulumtuesi shqyrton dhe analizon dokumente të ndryshme si kurrikulën, planet zhvillimore të shkollës, vendimet etj. | Të kuptojë më mirë çështjet arsimore, vizionin dhe misionin e shkollës, marrëdhëniet me komunitetin etj. |

SHEMBULL

Pyetja e hulumtimit: **Çfarë ndikimi ka të nxënët ndërveprues në përqendrimin e nxënësve në klasa të kombinuara?**

| Lloji i të dhënave | Si janë mbledhur? | Pse këto të dhëna janë të rëndësishme? |
|------------------------------|---|---|
| Intervistë me prindër | Kam intervistuar prindërit e nxënësve të klasës sime për të marrë mendimet e tyre për sjelljet e nxënësve në shtëpi, si sillen dhe çfarë bëjnë. | Mendoj se prindërit do të shprehin pozitivisht për sjelljet e fëmijëve të tyre, por kam dashur që ata të përfshihen që në fillim në procesin e hulumtimit dhe që më vonë të marrin përgjegjësi për sjelljet e fëmijëve në shkollë. |
| Vëzhgim në klasë | Kam përgatitur fletë-vëzhgimin me kode të caktuara që të vëzhgoj më shpejt çdo sjellje të nxënësve. | Vëzhgimet në klasë ndihmojnë në një përfytyrim të shpejtë për 'shpërqendrimin' e nxënësve gjatë aktiviteteve mësimore. Të dhënat për secilin nxënës të pasqyruar në fletë-vëzhgim ndihmojnë në organizimin e aktiviteteve të përshtatshme për secilin nxënës. |
| Pyetësor me nxënës | Pyetësor i përgatitur për nxënës | Përgjigjet e nxënësve në pyetësor japin informacion të qartë për mendimet e nxënësve dhe qëndrimet e tyre për aktivitetet në klasë. Poashtu, në pyetjet e hapura ata shprehin lirshëm për idetë që mua si mësimdhënës/e më ndihmojnë për planifikime të mëtejme të mësimin. |

Shembuj për vëzhgimin në klasë

Kur mësimdhënësit vëzhgojnë në klasë njëri- tjetrin, të gjithë kanë parasysh mënyrat më të thjeshta për mbledhjen e informacionit në lidhje me temat kryesore, si p.sh. pyetjet që bën mësimdhënësi (nxënësi), sjelljen e nxënësve, aktivizimin e nxënësve, qëndrimin pasiv të tyre apo menaxhimin e orës.


Para hartimit të listës së kontrollit, është mirë që të bëjmë disa pyetje të cilat na ndihmojnë në organizimin e vëzhgimit, si:

- Cili është qëllimi i vëzhgimit?
- Cilat sjellje të nxënësve janë më të vlefshme për t'u vëzhguar?
- Cili është fokusi i vëzhgimit?
- Cilat metoda të mbledhjes së të dhënave do t'i shërbejnë këtij qëllimi?
- Si do të shfrytëzohen të dhënat?


SHEMBUJ:

Vëzhgimi në klasë dhe regjistrimi i të dhënave:

1. *Shpërndarja e pyetjeve:* (Rrathët paraqesin nxënësit, numri brenda rrathëve paraqet numrin e pyetjes për të cilën nxënësi ka dhënë përgjigje dhe rrethi i zbrazët paraqet nxënësin që nuk ka dhënë fare përgjigje).



2. *Përgjigjet vullnetare dhe 'të kërkuara':* Shënojmë me V dhe K përkatësisht.



3. *Regjistrimi 'tekstual' i pyetjeve dhe përgjigjeve:* (Shfrytëzimi në formë të shkurtuar.

M: Cilat janë vetitë?

Arta: Ngj, F, M....? (ngjyra, forma, madhësia)

M: Çfarë i dallon K dhe R....? (katrorin dhe rombin)

4. *Reagimi i mësimdhënsit në përgjigjet e nxënësve*: Shfrytëzimi i shkurtesave.

F = reagim me fjalë

JF = reagim jo me fjalë

+ = shfaqje e reagimit pozitiv

0 = nuk reagon

- = shfaqje e reagimit negativ

| Pyetja | Përgjigjet | | | | |
|---------------|------------|----------|----------|----------|----------|
| | F | JF | + | 0 | - |
| 1 | √ | | √ | | |
| 2 | | | | √ | |
| 3 | √ | | | | √ |
| 4 | | √ | | √ | |
| ... | | | | | |
| Totali | 6 | 5 | 3 | 4 | 1 |

Vëzhgimi i aktivizimit të nxënësve

- Identifiko gjatë një hetimi të shpejtë të gjithë nxënësit që nuk përqendrohen në mësim për çdo dy minuta. Për shembull, gjatë 'hetimit', pesë nxënës ishin të shpërqendruar.
- Shëno sjelljet të aktivizuar/jo të aktivizuar: Listo secilin 'hetim' (p.sh. çdo dy minuta)

| Hetimi | Të aktivizuar | | Jo të aktivizuar | |
|--------|---------------|----|------------------|-----|
| | Numri | % | Numri | % |
| 1 | 4 | 16 | 21 | 84 |
| 2 | 6 | 24 | 19 | 76 |
| 3 | 1 | 4 | 24 | 96 |
| 4 | 0 | 0 | 25 | 100 |
| 5 | 3 | 12 | 22 | 88 |
| 6 | 3 | 12 | 22 | 88 |
| 7 | 6 | 24 | 19 | 76 |
| 8 | 5 | 20 | 20 | 80 |
| 9 | 4 | 16 | 21 | 84 |
| 10 | 4 | 16 | 21 | 84 |
| Tot. | 36 | | 214 | |
| Mes. | | 15 | | 85 |

3. Shëno joaktivizimin (shpërqendrimin) e nxënësve duke shfrytëzuar kodet:

- Bisedon për gjëra jo të lidhura me detyrën
- Shkarravit kot
- Kotet
- Ngacmon fizikisht nxënësin tjetër

- 5. Bredh nëpër klasë
- 6. Orvatet të tërheqë vëmendjen
- 7. Të tjera

| Nxënësi | Hetimi | | | | | |
|---------|--------|---|---|---|-----|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | ... | % |
| Arta | 3 | 1 | | | | |
| Edi | 5 | | 4 | | | |
| Andi | 6 | 5 | | | | |
| Toni | | 5 | | | | |
| Hana | 1 | 1 | 3 | 2 | | |

Punë e pavarur: Shkruani pyetjen e hulumtimit dhe plotësoni tabelën e mëposhtme:

Pyetja e hulumtimit:

| Lloji i të dhënave | Si mendoni t'i mblidhni? | Pse këto të dhëna janë të rëndësishme? |
|--------------------|--------------------------|--|
| | | |

| Lënda: _____ | Data: _____ |
|--------------|-------------|
| | |
| | |
| | |

Listë e kontrollit me kode (check-list)

| Sjellja e nxënësit gjatë procesit mësimor | Lista e kontrollit - për sjelljen e nxënësit |
|---|--|
| A) Është i fokusuar dhe ndjek me vëmendje procesin mësimor | <input checked="" type="checkbox"/> |
| A ₁) Nuk është i fokusuar në procesin mësimor | <input type="checkbox"/> |
| B) Shfaq interesim për temat që shpjegohen | <input checked="" type="checkbox"/> |
| B ₁) Nuk është i interesuar për temat që ligjerohen | <input type="checkbox"/> |
| C) Shfaq shenja knaqësie dhe ndihet i motivuar dhe kreativ gjatë orës | <input checked="" type="checkbox"/> |
| C ₁) Nuk është i motivuar, bën zhurmë dhe pengon procesin mësimor | <input type="checkbox"/> |
| D) Bashkëpunon me mësuesin dhe shokët në lidhje me temat që shpjegohen | <input type="checkbox"/> |
| D ₁) Pengon shokët dhe nuk lejon bashkpunimin mes tyre | <input type="checkbox"/> |
| E) Përgjigjet saktë në pyetjet që i parashtrihen | <input checked="" type="checkbox"/> |
| E ₁) Nuk përgjigjet saktë në pyetjet që i parashtrihen | <input type="checkbox"/> |
| Shënime shtesë: | |



NEW ENGLAND
S. OLIVER
JUNIOR
HIGH
PORTWELL

BACKUP
north atlantic
Division
BASKETBALL

- 8.9
- 8.8
- 7.8
- 8.7
- 8.4
- 8.8
- 8.8
- 8.10
- 8.6
- 8.8

9.2

HAPI I KATËRT: ANALIZA E TË DHËNAVE


Analiza e të dhënave është një proces i përdorimit të të dhënave me qëllim që të nxjerren në pah informacione të dobishme që mundësojnë sugjerimin e përfundimeve dhe marrjen e vendimeve.

(Sigurohuni që keni të paktën tre ose më shumë forma të të dhënave për të analizuar)

Lloji i analizës varet nëse të dhënat janë sasiore apo cilësore.

Pyetjet:

- Cilat teknika mund të përdoren për të analizuar të dhënat sasiore?
- Çfarë teknika mund të përdoren për të analizuar të dhënat cilësore?
- Cilat burime dhe programe kompjuterike mund të jenë të dobishme?



Hapat e mëposhtëm ju ndihmojnë që të jeni të saktë dhe të besueshëm gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre.

1. Regjistroni me kujdes dhe me korrektësi vëzhgimet. Kontrolloni së paku dy herë të dhënat;
2. Përshkruani të gjitha fazat e mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre;
3. Sigurohuni se keni raportuar gjithçka që është e rëndësishme;
4. Jeni objektiv në përshkrimin dhe interpretimin e asaj që ju vëreni;
5. Shfrytëzoni burime të mjaftueshme. Vëzhgimet dhe analizat do të jenë më të besueshme nëse jeni në gjendje të gjeni modele të ngjashme që shfrytëzojnë dy ose më shumë forma të të dhënave;
6. Shfrytëzoni lloje të duhura të burimeve të të dhënave. Përshtatni ato me qëllimin e hulumtimit që bëni;
7. Vëzhgoni aq gjatë sa është e nevojshme. Planifikoni kohëzgjatjen e vëzhgimeve apo “veprimeve” në pajtim me pyetjen hulumtuese dhe kriteret e përcaktuara për “veprimet” që do të merrni.

Kriteret e cilësisë që duhet t’i keni parasysh gjatë mbledhjes dhe analizës së të dhënave:

Vlefshmëria - të dhënat janë përfaqësim i saktë i çështjeve që studiohen;


Besueshmëria - interpretimet e të dhënave kanë kuptim dhe janë të besueshme për të tjerët;

Bazueshmëria - mbledhja dhe analiza e të dhënave janë konsekuente (rezultatet riprodhohen edhe nga të tjerët);

TREKËNDËZIMI I TË DHËNAVE

Trekëndëzimi i të dhënave do të thotë të shohësh diçka nga më shumë se një perspektivë. Trekëndëzimi ju mundëson që ju të shihni të gjitha anët e situatave.

Mendoni një trekëndësh që një çështje e konsideron "situatën" që vëzhgon dhe pastaj burimet e ndryshme të të dhënave si dy çështje tjera:



Mos harroni: Diskutoni me "miqtë kritikë" për t'u siguruar se atë që po bëni ka bazueshmëri, është e vlefshme dhe e besueshme.

Hulumtimet kuazi- eksperimentale (KUAZI – VEPRIME)

Hulumtimet kuazi- eksperimentale janë të afërta me eksperimentet e vërteta. Në këto hulumtime, zgjedhja e subjekteve është e rastësishme. Modelet e hulumtimeve kuazi- eksperimentale përdoren në disa situata në të cilat mund të identifikohen dy ose më shumë grupe nxënësish që janë "të ndryshëm" nga njëri-tjetri dhe njëri nga të cilët përdoret si grup kontrolli, e tjetri si grup eksperimental.

Hulumtimet kuazi- eksperimentale përfshijnë "manipulimet" me mjedisin, dhe meqë edhe hulumtimi në veprim ka të bëjë me shqyrtimin e ndryshoreve në mjedisin e "ndryshueshëm" në klasë, ai mund të konsiderohet si hulumtim kuazi- në veprim.

Hulumtimet në veprim nuk paraqesin hulumtime për të provuar një hipotezë e as për të siguruar të dhëna që mund të përgjithësohen për një popullacion të gjerë. Hulumtimet sasiore, si për shembull hulumtimet kuazi eksperimentale, shfrytëzohen thjeshtë për të dhënë një "pamje" të asaj se çfarë ndodhë në një situatë të veçantë.

Raportimi i të dhënave sasiore duke shfrytëzuar tabelat dhe figurat

Tabelat paraqesin organizimin dhe raportimin e të dhënave sasiore në mënyrë pamore. Ato janë të dobishme sidomos kur duhet të raportohet një numër i madh i të dhënave numerike. Poashtu, ato ndihmojnë të organizojnë informacionin dhe ta bëjnë atë të gatshëm për lexuesin.

Konsideroni shembullin e mëposhtëm të marrë nga hulumtimi i një mësimdhënëseje me titull: "Shpeshtësia e testimeve në klasë dhe ndikimi i tyre në ngritjen e suksesit të nxënësve në lëndën e matematikës"

Tab.1.Rezultatet e analizës së pyetësorit për qëndrimet e nxënësve në lidhje me testet në matematikë

| Nr. | Pyetjet e pyetësorit | Alternativat | | | | | | | | |
|-----|--|--------------|-------|--------|-------|-----------|------|----------|------|--------|
| | | Gjithnjë | | Shpesh | | Ndonjëher | | Asnjëher | | Gjith. |
| | Grupimi i dytë (pyetjet vlerësuese) | Nr v | Përq. | Nr. v | Përq. | Nr v | Përq | Nr v | Përq | |
| 6 | Gjatë kësaj kohe kemi zgjedhur më shumë detyra të shtëpisë | 31 | 75.6 | 8 | 19.5 | 2 | 4.9 | 0 | 0 | 41 |
| 7 | A ju ka ndodhur t'i përsëritni gabimet e bëra në test pas korigjimit nga ana e mësimitdhënësit | 2 | 4.9 | 4 | 9.8 | 25 | 61.0 | 10 | 24.4 | 41 |
| 8 | Përmirësimet e bëra në detyrat e testit nga ana e arsimtares kanë qenë mjaft të qarta: | 35 | 85.4 | 2 | 4.9 | 4 | 9.8 | 0 | 0 | 41 |
| 9 | Do të dëshironim që edhe në të ardhmen të vlerësohemi në këtë mënyrë: | 32 | 78.0 | 4 | 9.8 | 5 | 12.2 | 0 | 0 | 41 |
| 5 | Testet e shpeshta do të ndikojnë në ngritjen e suksesit përfundimtar në lëndën e matematikës : | 34 | 82.9 | 1 | 2.4 | 3 | 7.3 | 3 | 7.3 | 41 |

Mesatarja e pikëve nëpër teste

| | Paratesti | Testi 1 | Testi 2 | Testi 3 |
|-------------------------|-----------|---------|---------|---------|
| Nr i nxënësve | 33 | 33 | 33 | 33 |
| Pikët e testit | 20 | 20 | 20 | 20 |
| Pikët maksimale në test | 660 | 660 | 660 | 660 |
| Pikët e fituara | 273 | 376 | 427 | 474 |
| % | 41.36% | 56.97% | 64.70% | 71.82% |

Për projektin hulumtues “Përdorimi i mjeteve audio- vizuale në lëndën e gjuhës angleze te nxënësit e klasës së tretë”, mësimdhënësja Edona, ka hartuar një Listë kontrolli me kodet: 1-Shumë mirë;2- Mirë dhe 3- Jomjaftueshëm, për të matur nivelin e shqiptimit të drejtë të fjalëve në gjuhën angleze:

Tab.2: Lista e kontrollit për shqiptimin e drejtë të fjalëve

| | | JAVA 1 | | | | | JAVA 2 | | | | | JAVA 3 | | | | | JAVA 4 | | | | |
|----|------------|--------|---|---|---|---|--------|---|---|---|---|--------|---|---|---|---|--------|---|---|---|---|
| | | H | M | M | E | P | H | M | M | E | P | H | M | M | E | P | H | M | M | E | P |
| 1 | Altin | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | |
| 2 | Andi | 1 | | | 2 | | 2 | | | 1 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | |
| 3 | Anita | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 1 | |
| 4 | Blendi | 1 | | | 2 | | 3 | | | 3 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | |
| 5 | Dior | 1 | | | 1 | | 2 | | | 2 | | 1 | | | 1 | | 2 | | | 2 | |
| 6 | Driola | 2 | | | 3 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 1 | | | 1 | |
| 7 | Ema | 2 | | | 2 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | |
| 8 | Enis | 1 | | | 2 | | 3 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | |
| 9 | Eriol | 1 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | |
| 11 | Era | 2 | | | 3 | | 3 | | | 3 | | 3 | | | 2 | | 3 | | | 3 | |
| 11 | Edonita | 2 | | | 1 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 1 | | | 2 | |
| 12 | Erzon | 3 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 1 | | | 1 | |
| 13 | Flutura | 3 | | | 3 | | 3 | | | 3 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | |
| 18 | Erion | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 1 | | 1 | | | 2 | |
| 19 | Shkelqim | 2 | | | 1 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 1 | | | 1 | |
| 20 | Sara | 3 | | | 1 | | 1 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 1 | | | 1 | |
| 21 | Shkurtjona | 3 | | | 3 | | 3 | | | 3 | | 3 | | | 3 | | 3 | | | 1 | |
| 22 | Laurent | 3 | | | 3 | | 3 | | | 3 | | 3 | | | 2 | | 2 | | | 3 | |
| 23 | Rrezarta | 2 | | | 3 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 2 | | | 2 | |
| 24 | Valjeta | 3 | | | 2 | | 2 | | | 2 | | 3 | | | 3 | | 3 | | | 3 | |

Figurat përfshijnë grafikët, diagramet ose pikturat. Poashtu, fotografitë, hartat, ilustrimet ose shembujt e punës së nxënësve emërtohen si figura. Për dallim nga tabelat, numërimi dhe emërtimet e të cilave shkruhen në pjesën e sipërme të tabelës, figurat numërohen njëjtë kurse përshkrimi i tyre shënohet nën figurën përkatëse (shih shembujt e paraqitur).

Krahasimi i tri ushtrimeve kontrolluese në hulumtimin “Shfrytëzimi i mjeteve të konkretizimit në mësimin e matematikës” - Merita




Fig. 1. Rezultatet e Ushtrimeve

Fig. 2 është marrë nga hulumtimi: “Aktivitetet kreative për përmbushjen e rezultateve të të nxënit sipas standardeve 0 deri 6 vjeç” të realizuar nga Arbresha dhe Argjenta.

Në Fig. 3 janë paraqitur punimet e nxënësve të klasës së mësimdhënësit Vllaznim, i cili ka shfrytëzuar hulumtimin në veprim për të përmirësuar të shprehurit me shkrim të 6 nxënësve të identifikuar si nxënës me vështirësi në të shkruar.




Fig.2. Ndarja e tophave sipas ngjyrës



Fig.3. Punimet e nxënësve bazuar në foto.

Analiza e të dhënave cilësore përfshin leximin e transkripteve të intervistave apo transkripteve të fokus grupeve dhe të dhënave tjera, zhvillimin e kodeve, kodimin e të dhënave, dhe nxjerrjen e lidhjeve ndërmjet pjesëve diskrete të të dhënave.

Hapat që duhet ndjekur:

1. *Shqyrtimi dhe njohja me të dhënat*
2. *Fokusimi në analizë:* Rishikoni qëllimin e projektit dhe identifikoni disa pyetje thelbësore, përgjigjet e të cilave dëshironi t'i analizoni; Shkruani 'aty për aty' – çfarë ju bie në mend; Merrni vendim nëse është e nevojshme për të dhëna shtesë, apo për të ndryshuar punën tuaj; Klasifikoni të dhënat.
3. *Klasifikimi i të dhënave* sipas kronologjisë dhe llojit;
4. *Organizimi i të dhënave* është i njëjtë me organizimin e kujtesës, dhe ai përbëhet nga këto tri pjesë: ruajtja, kodimi dhe përpunimi.
 - Ruajtja i referohet sistemit të organizimit të të dhënave në hapësirën fizike apo virtuale;
 - Kategorizimi dhe Kodimi ka të bëjë me procesin e klasifikimit dhe etiketimit të të dhënave;
 - Përpunimi i referohet metodave që shfrytëzohen për nxjerrjen e të dhënave të ruajtura dhe shfrytëzimin e tyre në mënyrë të kuptimshme.
5. *Përpunimi i të dhënave* siguron që të dhënat e shumta apo në numër të madh të reduktohen dhe në raportin përfundimtar të paraqiten në forma të ndryshme dhe atë:
 - Në pjesën kryesore të tekstit, si ekstrakt për mbështetje të një pike të veçantë;
 - Në shtesa, si kontekste të drejtpërdrejta për ekstrakte apo për përpunimin e një pike të veçantë;
 - Në arkiv, si material i përgjithshëm prej nga mund të nxjerren të dhënat.

Shembull i analizës së të dhënave cilësore (marrë nga projekti i HV "Zgjidhja e problemeve me fjalë dhe përshtatja me kërkesat e niveleve kognitive në lëndën e matematikës për klasën e tretë" i mësimdhënësës Rajmonda Kurshumlja)

Pas kategorizimit dhe kodimit të transkriptit të intervistës së nxënësve rreth qëndrimeve të nxënësve për punën bashkëpunuese për zgjidhjen e problemeve me fjalë janë nxjerrë këto qëndrime të përbashkëta:

Qëndrimet pozitive: Bashkëpunimi me të tjerët gjatë zgjidhjes së problemeve me fjalë na bën të ndihemi mirë dhe më të sigurt. Kur zgjidhim problemet së bashku e kemi më lehtë të gjejmë zgjidhjen. Gjatë punës së përbashkët kuptojmë më mirë fjalët në probleme. Përmes bashkëpunimit shprehim mendimet lirshëm dhe japim më shumë ide.

Qëndrimet negative: Nxënësit tjerë ndonjëherë pengojnë të përqendrohesh në detyrë. Kur di zgjidhjen, nuk kam nevojë për bashkëpunim.

Qëndrimet neutrale: Përmes punës bashkëpunuese zgjidhim problemet së bashku. Puna bashkëpunuese na mundëson të diskutojmë së bashku.

Punë e pavarur:

Shqyrtoni të dhënat 'cilësore' të projektit tuaj hulumtues - si do t'i gruponi ato?

Organizoni të dhënat: Kategorizoni dhe shfrytëzoni 'kodimin' e të dhënave;

Caktoni nëse ndonjë nga të dhënat janë të gabuara apo nëse disa prej tyre mungojnë;

Përcaktoni mënyrën se si do t'i përpunoni ato.

Disa shembuj të projekteve të realizuara nga mësuesit:

- *Përdorimi i teknikave të të nxënësve ndërveprues në klasat e kombinuara;*
- *Përfshirja e nxënësve hiperaktivë në klasa të rregullta;*
- *Ndikimi i portfolios në rritjen e përgjegjësisë për detyrat e shtëpisë;*
- *Ndikimi i lexim-kuptimit në matematikë në zgjidhjen e problemeve me fjalë në klasën e katërt;*
- *Si të nxiten nxënësit që të lexojnë shpejt dhe të kuptojnë atë që e lexojnë;*
- *Ndikimi i rubrikës së vetëvlerësimit në përmirësimin e gabimeve drejtshkrimore;*
- *Përdorimi i TIK dhe gjuhës angleze në të nxënësve të matematikës;*
- *Rëndësia e planifikimit të pyetjeve në të zhvilluarit e mendimit kritik;*
- *Ndikimi i lojës me role në zhvillimin e komunikimit të lirshëm të fëmijëve;*
- *Shfrytëzimi i teknikës së vizualizimit në të mësuarit e shkrim - leximit;*
- *Përpilimi i orarit të punës së nxënësve në shtëpi.*



HAPI I PESTË: SHKRIMI I RAPORTIT

Çfarë duhet të përmbajë një raport i hulumtimit në veprim?

[**Titulli i hulumtimit**.... Emri i hulumtuesit]

Përmbledhja: Përshkrim i shkurtër i kontekstit (shkollës, klasës apo institucionit), qëllimeve, metodologjisë, rezultateve dhe implikimit të projektit tuaj hulumtues.

Mbani mend: Përmbledhja është pjesa e parë e raportit tuaj dhe përshtypjet e para të lexuesve janë shumë të rëndësishme;

Hyrja:

- Përshkruani kontekstin dhe arsyetimin e këtij projekti. Cili është motivimi juaj personal dhe profesional?
- Çfarë rëndësie ka projekti, cilat janë qëllimet dhe objektivat e tij?
- Çfarë teme të veçantë shqyrton ky studim- pyetja/et e hulumtimit dhe hipoteza/at?
- Çfarë shpresoni të gjeni apo çfarë rezultate mendoni të fitoni?

Shqyrtimi i literaturës: Përmbledhje e shkurtër e projekteve tjera / artikujve/ studime të lidhura me temën tuaj dhe arsyetimi i ndihmës së tyre për projektin tuaj hulumtues;

Metodat:

- Arsyetoni pse e keni zgjedhur hulumtimin në veprim si metodologji?
- Përmbledhni hapat kryesorë nëpër të cilat kalon projekti juaj dhe afatin kohor të realizimit të tyre;
- Përshkruani kontekstin dhe planin e detajuar për përgatitjen dhe planifikimin e planit të veprimtimit/intervenimit;
- Përshkruani planin e detajuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre – merrni në konsiderim çështjet etike dhe vlefshmërinë;

Analiza e të dhënave dhe rezultatet:

- Si i keni analizuar të dhënat?
- Paraqitni rezultatet së bashku me dëshmitë/faktet (tabelat dhe figurat, ekstraktet e intervistave, citatat, apo dëshmitë e punës së nxënësve, fotografitë etj)
- Çfarë mund të mësoni nga të dhënat? Çfarë modele, ide dhe kuptime të reja keni gjetur?
- Çfarë kuptimi kanë këto modele, ide për praktikën tuaj? Për nxënësit tuaj? Për stafin tuaj?

Diskutimi dhe përfundimi:

- Cilat janë përfundimet e punës suaj hulumtuese?
- Diskutoni lidhjen e mundshme të rezultateve të projektit tuaj me ato që kanë gjetur të tjerët;
- Diskutoni reflektimet në situata të ndryshme dhe implikimet në praktikën tuaj profesionale;
- Shkruani rekomandime për kolegët tuaj dhe për politik- bërësit;
- Paraqitni kufizimet (nëse ka) gjatë procesit të hulumtimit në përgjithësi.

SUKSESE!

LITERATURA:

- Eliot, J. (1991) Action Research for Educational Change, Milton Keynes, Open University Press
- Cohen ,L; Manion, L.& Morrison, K. (2007). Research Methods in Education, Sixth Edition, London: Routledge.
- Hopkins, D. (1985). A teacher Guide to classroom research, Open University press, England
- Hollingsworth, S., Khan, M. S., Khoso, N.A., Qureshi, G. M. (2005).Unpublished manuscript on Action Research. Karachi,IRA/ESRA
- Kemmis, S. and McTaggart, R. (2005) Participatory Action Research: Communicative Action and the Public Sphere in N.K. Denzin and Y.S. Lincoln (eds) (3rd Edition)The Sage Handbook of Qualitative Research,Sage: London
- Koshy, V. (2010). Action Research for improving Educational Practice. Sage Publications Ltd.
- Kolb D. (1984) Experiential Learning: Experience as the Source of Learning and Development, New Jersey, Prentice Hall
- Mcniff. J & Whitehead,J. (2010), You and Your Action Research Project,London Routledge
- Miller, B.M., Greenwood, D. and Maguire, P. (2003) Why Action Research? Action Research. Sage Publication. Volume 1(1): 9–28:
- Sagor, R. (2010).Collaborative Action research for professional learning communities.Solut. Tree Press
- Schön, D. (1987) Educating the Reflective Practitioner. San Francisco: Jossey-Bass Publishers.
- Stenhouse, L. (1975) An Introduction to Curriculum Research and Development. London, Heinemann.
- Stringer, E, (2004). Action Research in Education. Pearson Education, Inc.
- Vula, E. Hulumtimi Veprues në arsim' (2010), Skriptë (Ligjerata të autorizuar) e botuar në kuadër të Programit CDP+ dhe në bashkëpunim me UP
- Vula, E. & Bërdynaj, L. (2011). Collaborative Action Research: Teaching of Multiplication and Division in the Second Grade of Primary School. TOJQI Vol.2.No 2
- Vula, E (2013). Action Research as a form of professional development of teachers (2012) AICE Conference Proceedings book,Tirana, Albania
- Vula, E. & Kurshumlia,R. (2013) Mathematics word problem solving for third grade (Collaborative action research). AICE Conference Proceedings book,Tirana, Albania
- Watts, H. (1985). When teachers are researchers, teaching improves. Journal of Staff Development, 6 (2), 118-127.

Burimet nga interneti:

- British Educational Research Association: <http://www.bera.ac.uk>
- Unicef, Convention on the Rights of the Childrens: <http://www.unicef.org/crc/>
- American Educational Research Association: <http://www.aera.net>
- Research Informed Practice Site (TRIPS): <http://www.standards.dcsf.gov.uk/research>.
- Programin Për Arsimin Themelor: <http://bep-ks.org/treasure-chest/>

SHTOJCA 1:

Raporti i hulumtimit të realizuar në kuadër të projektit të BEP: “Hulumtimi në veprim”

Shfrytëzimi i lojës me role për komunikim të lirshëm të fëmijëve 5-6 vjeç

Indira Huruglica-Zenelaj
indirahuruglica@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim, lidhur me lojën me role për komunikim të lirshëm të fëmijëve është shfrytëzuar metodologjia e hulumtimit në veprim. Përmes aktiviteteve të planifikuara jam munduar t'i ndihmoj fëmijët të komunikojnë lirshëm/natyrshëm në situata të ndryshme jetësore.

Plani im i veprimit në këtë punim ka përfshirë dy aktivitete të realizuara për fëmijë, rezultatet e të cilave kanë qenë mjaft “shpresëdhënëse” duke ndikuar në zhvillimin e shkathtësisë komunikuese. Gjithashtu kam realizuar edhe një pyetësor për prindërit, për të kuptuar se sa kohë kalojnë prindërit duke komunikuar me fëmijët e tyre dhe për çka komunikojnë më shumë. Përfundimet e këtij hulumtimi në veprim tregojnë se nëse u krijojmë kushte dhe iu japim mundësi, fëmijët përmes lojës në role të ndryshme komunikojnë më lirshëm dhe e percjellin mesazhin tek të tjerët.

FJALËT KYÇE

Lojë me role - Dramatizimi ose luajtja e rolit të një personazhi a karakteri sipas funksionit të tyre.

- Komunikim i lirshëm – Procesi i transmetimit të informacionit një fëmije apo grupi fëmijësh dhe marrja e interpretimi i tij prej tyre.
- Moshë parafillore - Përfshin fëmijët e moshës 5-6 vjeç.
- Zhvillimi gjuhësor-Ka të bëjë me formimin gjuhësor, pasurimin e fjalorit dhe më gjerë, komunikimin, p.sh një fëmijë 5-6 vjeçar kupton më shumë fjalë se ato që mund të thotë dhe përdor në të folurit e përditshëm.

HYRJE

Moshë parafillore është periudha në të cillën zhvillimi social-emocional, fizik, intelektual dhe gjuhësor kalon momente që ndikojnë në të gjithë jetën e njeriut.

Komunikimi i lirshëm i fëmijëve të kësaj moshe paraqet një aspekt të rëndësishëm të zhvillimit të fëmijëve dhe suksesit në shkollimin e mëtutjeshëm. Duke komunikuar lirshëm me moshatarët dhe me të tjerët fëmijët zhvillojnë shkathtësitë gjuhësore, pasurojnë fjalorin dhe i përdorin fjalët në kontekste të ndryshme, zhvillojnë imagjinatën dhe fitojnë shkathtësi komunikuese.

Gjate punës së përditshme kam vërejtur se shumica e fëmijëve të kësaj moshe hasin në vështirësi për të treguar një ngjarje nga jeta e përditshme.

Mundësi të mirë për të zhilluar komunikimin e lirë dhe efektiv të fëmijët na jep edhe loja me role. Kur fëmijët hyjnë në role, ata shprehen më lirshëm dhe i shprehin ndjenjat, emocinet dhe mendimet e tyre. Ata mësohen të komunikojnë me njëri-tjetrin duke përdorur në shumë raste shprehje që dëgjojnë nga mjedise të caktuara, si p.sh. "Të lutem, mund të më japësh një fletore?", "Sa kushton? Faleminderit!"

Përzgjedhja e një përralle, tregimi apo vjershe ku flitet për dëshirat dhe nevojat që kanë fëmijët për gjëra të ndryshme u mundëson fëmijëve të angazhohet në lojëra me role (p.sh. bën sikur është doktor, ndërtues, shofer etj.)

Prandaj, dhe dua të kuptoj se si ndikon loja me role në komunikimin e lirshëm të fëmijëve të moshës parafillore?

Për mbledhjen e të dhënave kam shfrytëzuar teknika të ndryshme: lista e kontrollit, pyetësi për prindër, vëzhgimi, videoregjistrimi dhe mbajtja e shënimeve.

Miqtë kritik të hulumtimit ishin koleget Njomza Dragusha –psikologe e shkollës dhe Flora Vokri-mësimdhënëse.

Rezultatet e hulumtimit pres të jenë ndihmesë për të zgjidhur shqetësimin sa i përket komunikimit të lirshëm të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç e pse jo edhe të nxënësve të klasave të para dhe të dyta.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Studiues të ndryshëm janë marrë me ndikimin e lojës me role për zhvillim të personalitetit të fëmijëve dhe komunikimin e lirshëm.

Studimet kanë treguar se fëmijët të cilët janë rritur në ambiente në të cilat është komunikuar lirshëm kanë pasur më pak probleme në të kuptuarit e gjuhës dhe në të shprehurit e saj.

Për çdo moshë të hershme, loja është e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës dhe të mësuarit e tij. Nuk është vetëm dicka fizike, ajo përfshin edhe aspekte kognitive, imagjinative, kreative, emocionale dhe sociale. (Dobson, 2004)

Loja e në veçanti loja me role është mënyrë shumë efektive që fëmijët t'i shprehin impulset e tyre, t'i eksplorojnë, të eksperimentojnë dhe t'i kuptojnë ato.

Shumë fëmijë nuk mund t'i shprehin emocionet dhe memoriet e tyre me dikë që e shohin për herë të parë, por duke i parë fëmijët tjerë duke luajtur në role i ndihmon profesionistët që merren me fëmijë që t'i vlerësojnë dhe t'u ndihmojnë atyre të jenë më të hapur duke i lidhur emocionet dhe ndjenjat e tyre (Russ, 2006).

Për t'i shprehur ndjenjat, mendimet dhe emocionet fëmijët kanë nevojë për ndihmën e të tjerëve për t'i shprehur disa aftësi dhe shkathtësi komplekse të tyre si psh: komunikimi, marrja e vendimeve, zgjidhja e problemeve, bashkëpunimi me bashkëmoshatarët etj.

Loja me role i ndihmon fëmijët që të bëhen komunikues dhe lexues të pavarur për të reflektuar në atë çka dinë dhe çka duhet të dinë. (Bennett *et al.*, 1997)

Loja me role është mënyrë efektive e të mësuarit të fëmijës pasi që inkurajon fëmijët të bëhen pjesëmarrës aktiv në të mësuarit e tyre dhe në interpretimin e përvojave (active learning). Loja me role ndikon në zhvillimin e shkathtësisë komunikuese të fëmijëve pasi që ata komunikojnë me njëri tjetrin në një ambient loje, ku ata ndihen të sigurtë nga interneti.

Një fëmijë që “maskohet” pas një roli ka mundësinë të jetë “dikush tjetër” dhe ndërkohë të tregojë rreth problemeve dhe shqetësimeve që ndien ai vet. (Lefteri Selmani&Aurela Zisi ,2006)

ÇËSHTJA

Fëmijët e moshës parafillore në shumë raste nuk kanë sukses të tregojnë rrjedhshëm një ngjarje nga jeta e përditshme.

- **Qëllimi i hulumtimit**

Fëmijët të komunikojnë lirshëm /natyrshëm për/dhe në situata të ndryshme jetësore.

- **Pyetja e hulumtimit është:**

Si ndikon LOJA ME ROLE në komunikimin e lirshëm të fëmijët e moshës 5-6 vjec?

Konteksti i shkollës dhe pjesëmarrësit: Hulumtimi në veprim është zhvilluar me grupin parafillor të shkollës fillore Dardania në Prishtinë.

Në hulumtim morën pjesë 52 fëmijë- disa drejtëpërdrejtë e ca të tjerë në mënyrë indirekte.

PLANIFIKIMI I HULUMTIMIT

Plani i veprimit 1-Dëgjimi, dramatizimi dhe interpretimi i kuptimit

Sipas planit 1, aktiviteti i veprimit ka qenë dëgjimi i përrallës dhe pastaj interpretimi i kuptimit të asaj që kanë dëgjuar. Përgjigjet e fëmijëve pas dëgjimit të përrallës ishin thuajse të gjitha gjysmake. Pastaj fëmijët kanë qenë të lirë në përzgjedhjen e rolit nga përralla. Pas përzgjedhjes së rolit ata kanë dëgjuar edhe një herë përrallën dhe pastaj kanë hyrë në role.

Gjatë kohës kur fëmijët kanë luajtur rolet nga përralla, ata janë vëzhguar nga unë dhe psikologjia e shkollës dhe ne kemi plotësuar listën e kontrollit.

Të qenit brenda një personazhi iu ka ndihmuar shumë fëmijëve që ta pëcjellin mesazhin nga përralla. Gjatë luajtjes së roleve, fëmijët komunikojnë shumë më lirshëm dhe arrinin t'i interpretonin ngjarjet nga përralla. Gjithashtu edhe fëmijët pasiv, pra ata të cilët ishin vetëm shikues, kanë arritur që shumë më mirë ta kuptojnë dhe interpretojnë ngjarjen nga përralla dhe kam vërejtur një gatishmëri të madhe për të qenë edhe ata pjesë e roleve.



Rolet nga përralla „Ujku dhe shtatë edhat”



Dramatizimi i përrallës” Ujku dhe shtatë edhat”

Pyetësi për prindër,

Pyetësi për prindër ishte anonim. Atij iu përgjigjën 38 prindër. Nga pyetësi kuptova se prindërit kalonjnë kohë të mjaftueshme me fëmijët e tyre dhe se komunikojnë shumë me ta.

Plani i veprimit 2- Fëmijët në role të profesioneve të ndryshme /prindërve

Që fëmijët t’i luajnë rolet sa më mirë, kam bashkëpunuar me prindërit dhe kemi përcaktuar disa detyra.

Detyrat e prindërve.

- Të ekspozojnë profesionet (punën) e tyre para fëmijëve
- Të përgjigjen në pyetjet e fëmijëve
- T’i nxisin fëmijët për pyetje në rast se ata nuk tregojnë interesim për profesionet e tyre.

PLANI I VEPRIMIT 3 :

Bashkepunimi me prindërit

- Të sigurojmë mjetet të cilat do t'u ndihmojnë fëmijëve të luajnë rolet.
- Krijimi i mjedisit të përshtatshëm për të realizuar lojën me role.


Pasi fëmijët kanë vizituar vendin e punës të prindërve të tyre, ata janë kthyer në klasë dhe me ndihmën e mjeteve të ndryshme kanë luajtur role te ndryshme. Secili fëmijë ka pasur mjetet përkatëse për profesionin të cilin e ka luajtur.

Për mjetet dhe mjedisin e përshtatshëm jemi kujdesur së bashku me prindërit. Fëmijët në role kanë qenë në gjendje që shumë më qartë dhe më lirshëm ta përcjellin kuptimin e asaj qfarë kanë mësuar apo dashur të na tregojnë .

Tre fëmijë kanë pasur ndryshime të vogla gjatë komunikimit në lojën me role, por për ata do të ketë aktivitete dhe situata më të përshtatshme gjatë vitit shkollor.

Analiza e të dhënave dhe rezultatet

Sa i përket dramatizimit të përrallës së bashku me miken time kritike, psikologjen e shkollës, kemi vëzhguar fëmijët dhe kemi plotësuar listën e kontrolollit. Në bazë të rezultateve të fituara përmes përgjigjeve të fëmijëve në dramatizim kam arritur të kuptoj se ata kanë dhënë përgjigje më të plota dhe më të kuptueshme. Mesazhi që fëmijët kanë përcjellë nga përalla ka qenë më i fortë dhe më bindës për mua dhe për fëmijët tjerë.



Më pas, realizova **një pyetësor me prindër**. Të dhënat e fituara nga pyetësi bënë të kuptoj se prindërit kalojnë mjaft kohë duke komunikuar me fëmijët e tyre.

- Në pyetjen: *I kushtoni rëndësi komunikimit më fëmijën tuaj gjatë ditës?*
36 prindër kanë deklaruar *shumë* dhe 2 prindër *pak*. Nga këto të dhëna kuptoj se prindërit i kushtojnë rëndësi komunikimit me fëmijët e tyre.
- Në pyetjen: *Diskutoni me fëmijën tuaj rreth librave të ilustruar?*
30 prindër kanë deklaruar *shumë* dhe 8 prindër *pak*. Nga këto të dhëna kuptoj se prindërit diskutojnë shumë me fëmijët e tyre rreth librave të ilustruar
- Në pyetjen: *Komunikon lirshëm vajza/djali juaj në shtëpi?*
37 prindër kanë deklaruar *shumë* dhe 1 prindër *pak*. Nga këto të dhëna kuptoj se fëmijët me prindërit e tyre në shtëpi komunikojnë lirshëm.
- Në pyetjen: *Komenton rreth filmave të vizatuar vajza/djali juaj në shtëpi?*
23 prindër kanë deklaruar *shumë* dhe 15 prindër *pak*. Nga këto të dhëna kuptoj se prindërit dhe fëmijët mesatarisht komunikojnë për filmat e vizatuar.
- Në pyetjen: *Pëlqen teatrin me kukulla vajza/djali juaj?*
28 prindër kanë deklaruar *shumë* dhe 10 prindër *pak*. Nga këto të dhëna kuptoj se më shumë fëmijët pëlqejnë teatrin, por nuk kam të dhëna se sa e vizitojnë.
- Në pyetjen: *Për çfarë komunikoni më shumë me fëmijën tuaj?*
15 prindër kanë deklaruar se bisedojnë shumë çka me fëmijët e tyre, 7 prindër për aktivitetet në parashkollor dhe lojëra, 8 prindër për libra dhe shoqëri, 4 për talentet dhe interesimet e fëmijëve, 4 për miqsjellje në rrugë, shkollë.
- Në pyetjen: *Për çfarë shprehet më lirshëm fëmija juaj?*
23 prindër kanë deklaruar *për shumëçka*, 7 për shkollë dhe lodra 8 për filma dhe lojëra.

Fëmijët në role të profesioneve të ndryshme

Aktiviteti më i këndshëm ishte kur fëmijët përmes roleve luajtën profesionet e prindërve të tyre. Gjatë kohës kur fëmijët luanin rolet, unë i kam vëzhguar dhe performancat e tyre i kam krahasuar me ato para roleve. Ka qenë pak e vështirë që me precizitet t'i masë paraqitjet e tyre por jam munduar të jem sa më reale në gjykimet e mia.

Shumica e fëmijëve në role kanë komunikuar shumë lirshëm /natyrshëm dhe kanë përcjellë të kuptuarit në mënyrë shumë natyrale.

Tre fëmijë të cilët nuk treguan mjaft sukses morën përsëri role dytësore në bashkëpunim me fëmijët e tjerë. Aty kanë qenë më të relaksuar sepse nuk ishin në role kryesore dhe kanë dhënë më shumë nga vetja. p.sh vajza e cila nuk e luajti rolin e vet, u bë se kishte dhimbje dhëmbi dhe iu bashkangjiti rolit të mjekut duke i kërkuar ndihmë për shqetësimin e saj.

Gjatë kohës sa fëmijët luajtën rolet e tyre bashkëvepronin dhe komunikonin me njëri-tjetrin dhe gjithashtu i shprehnin edhe emocionet dhe qëndrimet e tyre.



Farmacisti



Zyrtare në postë



Zana e verës




Mësuesja



Mjeku




Stomatologu



Stomatologu dhe pacientja



Gazetarja për fëmijë



Polici



Mësuesja

PËRFUNDIMI

Hulumtimi në veprim i realizuar, së pari ka dhënë përgjigje në shqetësimin tim, por gjithashtu ka ndikuar dhe në komunikimin e lirshëm të fëmijëve. Rezultatet e fëmijëve të përfshirë në role treguan se fëmijët mund të përparojnë në komunikim, por iu nevojitet mbështetje dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për të realizuar lojën me role.

Fëmijët e grupit gjatë kohës sa kemi praktikuar të mësuarit përmes lojës me role, përpos se janë liruar në komunikim njëkohësisht edhe janë argëtuar shumë.

Ky hulumtim ka qenë një mënyrë mjaft e mirë për përmirësimin e komunikimit të lirshëm të fëmijëve të moshës 5-6 vjeç dhe do të vazhdoj edhe me tutje të praktikojë lojën me role me qëllim që fëmijët të bëhen komunikues dhe lexues të pavarur për të reflektuar në atë çka dinë dhe çka duhet të dinë. (Bennett *et al.*, 1997)

Disa rekomandime:

- Loja me role të aplikohet sa me shpesh te fëmijët e grupeve parafillore dhe gjithashtu edhe tek nxënësit e klasës së parë dhe te dytë (nivelit të parë të shkallës së parë) për t'i zhvilluar aftësitë komunikuese të fëmijëve.
- Bashkëpunim prind– mësimdhënës, si dhe profesionistët tjerë, që të krijojnë kushte të favorshme për aplikimin e lojës me role,
- Prindërit të kalojnë më shumë kohë duke komunikuar me fëmijët e tyre rreth çështjeve të ndryshme.

BURIMET

- Dobson, F. (2004). Getting Serious About Play - A Review of Children's Play. London, U.K. Department for Culture, Media and Sport: 60.
- Bennett, N., Eood, L. & Rogers, S. (1997) Teaching through Play: teachers' thinking and classroom practice. Buckingham: Open University Press.
- Virginia M. Axile. Play Therapy. Ballantine Books .Neë York
- Hap pas hapi nje program per femije dhe familje-Krijimi I klasave me femije ne epiqender/ organizata Boterore e Burimeve Per Femije –Uashington DC
- A manual for the 21st century classroom Introduction
- Active Learning
- Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet.
- Lefteri Selmani&Aurela Zisi(2006)Konceptimi dhe organizimi I veprimtarisë mësimore edukative në arsimin parashkollor,GEER,

<http://psychcentral.com/news/2006/10/26/play-therapy-helps-kids-express-emotions/360.html>

<http://www.teachpreschool.org/2011/06/role-play-in-early-years/>

<http://www.kallikids.com/>

<http://education.enmu.edu/cte/pdf/s/2006-07ARGBook.pdf>

SHTOJCAT

Lista e kontrollit

Listae kontrollit: UJKU DHE SHTATË EDHAT

Pyetja: Ku jetonte nëna dhijë me shtatë edhat e saj?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2. Pas lojës me role

nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja: Kur u tha nëna edhave të kenë kujdes nga ujku?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2. Pas lojës me role

nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja: Kur shkoi ujku te edhat?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2. Pas lojës me role
nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja: Pse shkoi ujku në shitore?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës.

2. Pas lojës me role
nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja: Si e dalluan ujkun që nuk ishte nëna e tyre?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2. Pas lojës me role
nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja: Si i mashtroi ujku edhat?

Përgjigjja:

1 Pas dëgjimit të përrallës.

2. Pas lojës me role
nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja: A shpëtoi ndonjëri nga edhat?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2.Pas lojës me role
nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja: Si e kuptoi nëna dhijë se çfarë kishte ndodhur?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2. Pas lojës me role
nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

Pyetja:Ku i gjeti nëna të vegjëlit e saj?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2. Pas lojës me role
nxenesit aktivë

nxenesit pasivë

Pyetja:Për çfarë u gëzuan shumë shtatë edhat?

Përgjigjja:

1. Pas dëgjimit të përrallës

2. Pas lojës me role
nxënësit aktivë

nxënësit pasivë

| | | | Lista e kontrollit | | | |
|--------------------|---------------------------|--------------------|-------------------------------|----------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Fëmijët në rolin e | Pas dëgjimit të përrallës | | Pas lojës me role | | | |
| | | | Fëmijët aktivë | | Fëmijët pasivë | |
| | Fjali me 2-3 fjalë | Fjali me 5-6 fjalë | Fjali me 2-3 e më shumë fjalë | Fjali 5-6 e më shumë fjalë | Fjali me 2-3 e më shumë fjalë | Fjali me 5-6 e më shumë fjalë |
| Ujku | | | | | | |
| Nëna dhijë | | | | | | |
| 7 edhat | | | | | | |
| Shitësi | | | | | | |

Pyetësor për prindër

1. I kushtoni rëndësi komunikimit më fëmijën tuaj gjatë ditës?

- A) Shumë
- B) Pak
- C) Aspak

2. Diskutoni me fëmijën tuaj rreth librave të ilustruar?

- A) Shumë
- B) Pak
- C) Aspak

3. Komunikon lirshëm vajza/djali juaj në shtëpi?

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

4. Komenton rreth filmave të vizatuar vajza/djali juaj në shtëpi?

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

5. Pëlqen teatrin me kukulla vajza/djali juaj?

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

Për çfarë komunikoni më shumë me fëmijën tuaj?

Për çfarë shprehet më lirshëm fëmija juaj?

Ju falënderoj për kontributin tuaj!

MJETET E KONKRETIZIMIT NË MËSIMIN E MATEMATIKËS

MERITA KELMENDI

PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte gjetja e mënyrave sa më frytdhënëse për mësimin e matematikës dhe e zgjidhjes së problemeve matematikore duke përdorur materiale konkretizuese dhe recikluese.

Hulumtimi është zhvilluar në shkollën fillore "Dardania" në Pejë nga data 8 tetor deri me 16 nëntor, në klasën 5/4 me 25 nxënës dhe në disa klasa të tjera të po kësaj shkolle. Hulumtimi rrjedh si pasojë e ndjekjes së kursit Hulumtimi në Veprim, organizuar nga Basic Education Program dhe me udhëheqjen e profesoreshes Eda Vula dhe mësueseve Rajmonda Kurshumlia e Afrore Lila.

Përfundimet e nxjerra nga ky hulumtim deshmojnë se lënda e matematikës është lëndë që mësohet lehtë edhe nga ata më pesimistët poqese gjendet mënyra e drejtë për shpjegimin dhe mësimin e saj.

Metodologjia e këtij punimi ishte hulumtimi në veprim. Për mbledhjen e të dhënave janë shfrytëzuar disa teknika si: intervistat me prindër, pyetësi për nxënës, vëzhgimi, kontrolli i detyrave të shtëpisë, fletë ushtrimi dhe teste.

Qëllimi i hulumtimit ishte gjetja e mënyrave dhe aktiviteteve të ndryshme të cilat do të ndikojnë pozitivisht te nxënësit në të nxënit e problemeve dhe detyrave matematikore.

Fjalë kyçe: matematikë, mjete konkretizimi, të nxënit.

IDENTIFIKIMI I PYETJES SË HULUMTIMIT

Tema ime e hulumtimit është e motivuar nga përvija ime e përditshme me nxënësit dhe me të nxënit e lëndës së matematikës. Të gjithë jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e lëndës së matematikës dhe koorelacionit të saj me të gjitha fushat e jetës.

Nga intervistat e zhvilluara me prindër kam ardhur në përfundimin se jo vetëm fëmijët frikësohen nga matematika. Pra shpesh, akoma pa u njohur fare me lëndën e matematikës krijohet paragjykimi për këtë lëndë.

Mirëpo sipas mendimit tim dhe të disa kolegëve të mi me të cilët jam konsultuar, problemi nuk qëndron te lënda e matematikës por mënyra se si shpjegohet akoma në shkollat tona kjo lëndë.

Duke u munduar që të shqyrtoj literaturë të disponueshme për këtë problematikë kam vërejtur që problemi kryesor qëndron pikërisht tek mënyra e mbajtjes së orës së matematikës.

Nxënësve shpesh u kërkohet që të mësojnë procedura matematikore, rregulla dhe definicione pa e kuptuar përse e bëjnë një gjë të tillë. Ata jo gjithmonë arrijnë t'i kuptojnë shprehjet, fjalët dhe simbolet matematikore.

Nxënësit kryejnë veprime të ndryshme matematikore duke mos e ditur se ato do t'i shërbejnë në jetën e tyre praktike. Dhe mbi të gjitha, nxënësve nuk u ofrohet mundësia që të veprojnë si matematikanë të vërtetë duke eksploruar materiale të ndryshme të përshtatshme për moshën. Në shkollat tona fatkeqësisht matematika ende shtjellohet si lëndë që mësohet me laps e letër dhe nxënësit mbesin të humbur në atë botë të numrave dhe shprehjeve matematikore. Në pyetjen time drejtuar nxënësve se a e dini përse e mësojmë matematikën? - ata janë përgjigjur *për të kryer detyra*.

Në anën tjetër shkollat janë pak ose nuk janë fare të pajisura me mjete konkretizimi. Kjo punë i mbetet secilit mësues si detyrë që vetë me imagjinatën dhe mundësinë e tij të sigurojë mjete konkretizimi ose materiale recikluese që do t'u hynin në punë për të zhvilluar sa më efektivisht orën e matematikës.

Të gjithë këta faktorë ndikojnë që fëmijët mos të aftësohen sa duhet në kryerjen e probleme matematikore dhe frika e mosbesimi i tyre shtohet edhe më shumë.

Në anën tjetër, një nga qëllimet më të rëndësishme të mësimdhënies të matematikës është të mësojmë nxënësit të mendojnë, që të kenë mundësi të zgjedhin probleme të ndryshme me të cilat do të ballafaqohen në jetën e tyre.

Andaj roli i mësuesit shkon përtej ligjërimit të lëndës dhe dhënies së informacioneve të gatshme. Roli i mësuesit është që të krijojë mjedis të përshtatshëm mësimor, të zgjedhë objekte të përshtatshme dhe të inkurajojë dhe udhëzojë nxënësit që në mënyrë të pavarur të zbulojnë koncepte të reja dhe të drejtohen në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Ne mësuesit nuk kemi mundësi t'i japim vetes luksin që të punojmë vetëm me fëmijet që "kanë dëshirë të mësojnë" ose me ata që kuptojnë lehtë.

Mund të pyetemi se si të orientohe mi në hulumtim kur jemi kaq shumë të ngarkuar me plane dhe programe të rregullta mësimore. Por, besoj se pikërisht hulumtimi do të na ndihmojë që të shohim problemet me të cilat ballafaqohemi çdo ditë. Mendoj se hulumtimi në veprim do të ndihmojë në mësimdhënien tonë dhe në përparimin e praktikës mësimdhënëse. Kjo problematikë më ka motivuar që të hulumtoj pikërisht këtë temë dhe të përpiqem për t'i aftësuar nxënësit në zgjidhjen e problemeve dhe veprimeve të ndryshme matematikore.

Pyetja kryesore e hulumtimit është:

Si ndikojnë mjetet e konkretizimit në mësimin e matematikës?

SHQYRTIMI I LITERATURES

Mjetet e konkretizimit në të nxënësit e matematikës

Duke konsultuar literaturë të ndryshme lidhur me çështjen time të hulumtimit, kam vërejtur se problemi nuk ekziston vetëm në shoqërinë tonë por është i pranishëm edhe në shoqëritë më të zhvilluara. Frika nga matematika është e pranishme, mirëpo, mënyra e qasjes ndaj saj ndryshon shumë në vendin tonë (në të kaluarën) dhe në vendet e tjera të zhvilluara.

Ja çfarë mendojnë disa autorë të huaj lidhur me çështjen në fjalë.

Matematika është çdokund rreth nesh. Ajo na ndihmon në jetën tonë të përditshme, sepse matematika është një orë që na zgjon në mëngjes në kohën e caktuar, numri i karrigeve që kemi në shtëpi, sasia e qumështit që një fëmijë duhet të pijë gjatë ditës, numri i kopsave në një këmishë, kube druri me të cilat fëmija luan çdo ditë, grupimi i lodrave sipas kriterëve të caktuara, etj. Matematika është mjet i fuqishëm i komunikimit, shpjegimit dhe vlerësimit. Ajo ka “gramatikën” dhe “sintaksën” e vet dhe rëndësinë universale (T.Lehrer 1972).

Disa nxënës e duan matematikën, sepse gjejnë kënaqësi intelektuale dhe estetike që ajo ofron. Të tjerët, megjithatë, mendojnë se nuk mund ta kuptojnë botën e numrave dhe operacioneve matematikore. Ky mendim natyrisht është i gabuar, sepse të gjithë mund të mësojnë bazat e matematikës dhe t’i përdorin ato me sukses në jetë.

Ka mënyra të ndryshme më të cilat ne mund të inkurajojmë fëmijët të mësojnë numrat dhe konceptet matematikore: mund të numërojmë një grumbull arra, një mollë ta ndajmë me vëllain, ose ëmbëlsirat t’i ndajmë me fëmijët e tjerë. Të masim gjatësinë e shokëve të klases, të peshojmë gjëra të ndryshme ushqimore, të pyesim fëmijet për orën e nisjes dhe qëndrimit në shkollë, të numërojmë paratë e nevojshme për blerjen e vezëve dhe bukës, të bëjmë lista të lojërave dhe ushqimeve që pelqejmë, të luajmë lojëra matematikore si: mos u zemëro njeri, domino, letra të kujtesës, pikado etj. Atëherë fëmijët do të kuptojnë se çfarë janë numrat në jetën reale dhe cila është rëndësia e matematikës. (Tom Lehrer 1972).

Tom Lehrer (1972) po ashtu thekson se një vizatim dhe prekje e objektit konkret vlen më shumë se 1000 fjalë andaj sa herë që ofrohet një mundësi e tillë ta shfrytëzojmë sepse kështu matematika bëhet më e lehtë për fëmijët.

Megjithatë profesori Bedri Jaka (2008) thotë se mjetet e konkretizimit luajnë rol të rëndësishëm në mësimin e matematikës, por gjithsesi të kufizuar. Në çastin kur është e mundur, duhet të lirohemi prej tyre dhe punës kërkimore-miniaturale duhet t’i qasemi pa to. Po që se aplikohen, atëherë ka shumë rëndësi jo vetëm shikimi por edhe të prekurit e mjeteve mësimore. Sukses i përfundimtar i të mësuarit të matematikës nuk varet ekskluzivisht nga fakti sa të pasur jemi me mjete të konkretizimit dhe në fund mund të konstatojmë se: “Matematika mësohet më së miri me laps në dorë” (B.Jaka 2008)

REALIZIMI I HULUMTIMIT

Metodologjia e këtij punimi ishte hulumtimi në veprim. Nxënësit dhe prindërit janë njoftuar se për disa javë rresht do të realizojmë një hulumtim për të parë se si do të ndikojë një formë e re e mësimdhënies në të mësuarit e matematikës.

Në fazën e parë të hulumtimit kam përpiluar një pyetsor për nxënësit duke dashur të kuptoj situatën aktuale dhe mendimet e nxënësve për disa çështje. Kam vazhduar me vëzhgimin e materialeve të disponueshme si testet, detyrat e shtëpisë dhe të klasës si dhe vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i nxënësve. Poashtu kam arritur të intervistoj edhe disa prindër.


Në fazën e dytë kam përpiluar planin e veprimit. Duke u munduar që të respektoj planprogramin mësimor kam kërkuar edhe ndihmën e kolegeve të mija të cilat kanë zhvilluar njësi mësimore të përshtatshme. Kam grumbulluar materiale të ndryshme konkretizimi dhe mjete tjera të nevojshme.

Në fazën e tretë kam zhvilluar një anketë me nxënësit për të parë rezultatet dhe përshtypjet lidhur me mënyren e re të trajtimit të problematikave matematikore. Poashtu test dhe ushtrime kontrolluese për të parë cilat janë rezultatet e nxënësve pas veprimit dhe përdorimit të mjeteve konkretizuese.

Rezultatet e pyetësorit të parë me nxënësit;


1) Lëndën e matematikës e dua

- a) sa lëndët tjera 13 nxënës
- b) më shumë se lëndët tjera 10 nxënës
- c) më pak se lëndët tjera 2 nxënës




2) Matematika është vështirë

- a) gjithmonë 4 nxënës
- e) ndonjëherë 17 nxënës
- c) asnjëherë 4 nxënës




3) Detyrat e matematikës i kryej vetë

- | | |
|---------------|-----------|
| a) gjithmonë | 8 nxënës |
| b) ndonjëherë | 14 nxënës |
| c) asnjëherë | 3 nxënës |



4) Detyrat e matematikës i kuptoj

- | | |
|---------------|-----------|
| a) gjithmonë | 5 nxënës |
| b) ndonjëherë | 17 nxënës |
| c) asnjëherë | 3 nxënës |



Nga këto të dhëna kuptova që përkunder dashurisë që kanë për lëndën e matematikës, nxënësit kanë vështirësi në të nxënit e saj. Ata pohuan se jo gjithmonë i kuptojnë detyrat, kështu që shpesh kanë nevojë për ndihmen e dikujt.

Duke u bazuar në këto të dhëna fillova të ndryshoj mënyren time të mësimdhënies duke u munduar që nxënësve në çdo rast të mundshëm t'u bëj paraqitjen e duhur vizuale, të përdor vizatime, fjalor matematikor dhe mjete tjera të disponueshme.

Në fazën e parë të hulumtimit poashtu kam realizuar edhe një ushtrim kontrollues në të cilin janë përfshirë njësitë e mësuara deri atëherë në mënyrën e vjetër të mësimdhënies. Rezultatet e ushtrimit të parë do t'i paraqes në tabelën në vijim:

USHTRIMI I PARË KONTROLLUES

| Pikët | 0-29 | 30-44 | 45-60 | 61-80 | 81-100 |
|------------------|----------|----------|----------|----------|-----------|
| Numri i nxënësve | 1 nxënës | 4 nxënës | 4 nxënës | 3 nxënës | 13 nxënës |
| Përqindja | 4 % | 16 % | 16 % | 12 % | 52 % |

Duke u bazuar në rezultatet e ushtrimit të parë kontrollues të cilat nuk ishin aq të kënaqshme, fillova që menjëherë të zhvilloj aktivitete mësimore të shoqëruara me mjete të ndryshme konkretizimi dhe lojëra matematikore. Fillimisht duhet cekur se interesimi dhe angazhimi i nxënësve ishte më i shprehur se më parë. Ata me kënaqësi pritnin orën e matematikës dhe aktivitetet që zhvilloheshin gjatë kësaj ore.

Në vazhdim do të paraqes disa shembuj:

Leximi dhe shkrimi i numrave pesëshifrorë



Aktivitet i zhvilluar me litarin tharës të rrobave-Nxënësit jo vetëm që janë argëtuar por edhe kanë mësuar shumë shpejtë të lexojnë numrat pesëshifrorë. Me po të njëjtin aktivitet kemi mësuar edhe numrat deri në një milion dhe nxënësve u është dashur më pak kohë për të mësuar leximin dhe shkrimin e numrave me 7 shifra. Ata kanë arritur që të kuptojnë vlerën e shifrës sipas vendndodhjes dhe sistemin dhjetor të numrave. Qysh në ditën e parë vetëm 3 nxënës kanë pasur akoma pasiguri.




Vlera e shifrave sipas vendndodhjes e zhvilluar me anë të lojës "Kush e gjen i pari". Nxënësit janë argëtuar dhe kanë mësuar.



Nxënësit gjatë pushimit duke ushtruar dhe përsëritur tabelen e shumëzimit. Gjatë pushimit vinin edhe nxënësit e klasave tjera dhe bënë lojëra dhe gara me mjetet e disponueshme. Kjo dëshmon se sa është e rëndësishme që nxënësit ta kenë gjithmonë në dispozicion një tabelë të tillë.

Fjalori matematikor

| Simbole | | matematikë | |
|---------|------------|------------|----------------|
| + | Plus | U | Unioni |
| - | Minus | ∩ | Prerja |
| • | Shumëzim | | Diferenca |
| • | Baranim | ∅ | Bashkimi boshe |
| = | Baranim | ∈ | Element |
| ≠ | Jegonim | ∉ | Jo element |
| < | Më e vogël | ⊆ | Numërtori |



Shpesh nxënësit nuk arrijnë të zgjidhin probleme matematikore sepse ata nuk janë në gjendje të kuptojnë fjalorin e matematikës. Disa nga këto punime kanë ndihmuar nxënësit e klasës II/4 që të kryejnë detyra me veprimet themelore të matematikës.

Muri thyesor



Lojëra matematikore

Duke marrë parasysh moshën e fëmijeve të shkollës fillore dhe duke u bazuar në shprehjen “Mëso duke luajtur dhe luaj duke mësuar” kam tentuar që aty ku është e mundshme të përdor lojëra të ndryshme atraktive për fëmijë si letrat e kujtesës, loja e letrave ,domino me thyesa, kalkulatori, kompletimi i origamit etj.

Disa nga këto aktivitete do ti paraqes në vijim:

Kalkulatori

Loja me kalkulator :nxënësit ushtrojnë tabelen e shumëzimit dhe pjesëtimit.

Nxënësit janë të ndarë në dy grupe dhe provojnë të mundin kalkulatorin. Më këtë rast ata konstatojnë se disa probleme zgjidhen më lehtë me mendje e disa më lehtë me kalkulator.

Ata poashtu aftësohen në përdorimin e kalkulatorit.



Origami



Loja me tre zare

Nxënësit u argëtuan duke formuar origamit, njëkohësisht mësuar dhe rikujtuar figurat gjeometrike. Mbledhjen me tre mbledhorë dhe barazimet me një mbledhor të panjohur i mësuar nxënësit e klases së dytë me lehtësi.


Rezultatet e ushtrimit të dytë kontrollues

| Pikët | 0-29 | 30-44 | 45-60 | 61-80 | 81-100 |
|------------------|----------|----------|----------|----------|-----------|
| Numri i nxënësve | 0 nxënës | 0 nxënës | 4 nxënës | 6 nxënës | 15 nxënës |
| Përqindja | 0 % | 0 % | 16 % | 24 % | 60% |

Rezultatet e pyetësorit të dytë


1) A ju pëlqen mënyra e re e mësimit të matematikës

- a) Shumë 24 nxënës
- b) Pak 1 nxënës
- c) Aspak 0 nxënës




2) A i kuptoni më lehtë problemet matematikore

- a) Shumë 21 nxënës
- b) Pak 3 nxënës
- c) Aspak 1 nxënës



3) Ju pëlqen pamja e klasës tani


- a) Shumë 21 nxënës
- b) Pak 3 nxënës
- c) Aspak 1 nxënës



Hapi i fundit i hulumtimit ishte testi përfundimtar i cili përmbante detyra nga njësiti e mësuara nga fillimi i hulumtimit në veprim.

| Pikët | 0-29 | 30-44 | 45-60 | 61-80 | 81-100 |
|------------------|----------|----------|----------|----------|-----------|
| Numri i nxënësve | 1 nxënës | 0 nxënës | 5 nxënës | 2 nxënës | 17 nxënës |
| Përqindja | 4 % | 0 % | 20 % | 8 % | 68 % |

Krahasimi i tre ushtrimeve kontrolluese



Duke parë edhe grafikonin ku krahasohen tri ushtrimet kontrolluese shihet qartë se ka pasur ngritje gjatë kesaj periudhe. Kjo na dëshmon edhe njëherë se mënyra e re e mesimdhënies ka dhënë rezultate. Rezultatet sigurisht do të jenë edhe më të mëdha me kalimin e kohës.

PËRFUNDIMI

Rezultatet nga ky hulumtim vërtetuan se matematika mund të jetë po aq e lehtë për t'u mësuar sa edhe lëndët tjera nese gjendet mënyra e drejtë dhe e duhur për shpjegimin e saj.

Poashtu ky hulumtim bëri të mundur edhe ndryshimin e bindjeve të nxënësve të cilët lëndën e matematikës e mendonin shumë të vështirë për t'u mësuar.

Interesimi dhe angazhimi i nxënësve ishte më i shprehur dhe ata e pritnin me padurim oren e matematikës.

Gjithashtu edhe prindërit janë shprehur se fëmijët e tyre tani kërkojnë me rrallë ndihmë dhe janë bërë më pak të varur nga ata.

Prandaj, ky hulumtim dëshmon se mësuesit duhet të planifikojnë sa më shumë aktivitete konkrete, të përdorin materiale konkretizuese dhe recikluese sa herë që e shohin të arsyeshme dhe të domosdoshme. Mësuesit duhet t'u deshmojnë nxënësve se *jeta është matematikë dhe matematika është jetë*.

REKOMANDIMET

- Nxënësit mund të përmirësojnë rezultatet e të nxënësve të matematikës nese mesimdhënësit e bëjnë lëndën më atraktive duke futur inovacione dhe risi.
- Mesimdhënësit duhet të zgjedhin forma të përshtatshme për motivimin e nxënësve në mësuarit e matematikës.
- Mesimdhënësit duhet të kërkojnë mënyra për pasurimin e klasave të tyre me mjete konkretizimi-eventualisht formimin e këndit të matematikës në klasë.
- Nxënësit duhet aftësuar që të lexojnë udhëzimet e detyrave dhe të bazohen në shembujt e dhënë për të zgjidhur probleme të ndryshme.
- Nxënësve duhet t'u sqarohet rëndësia e matematikës dhe lidhshmëria e saj me të gjitha fushat e jetës.
- Nxënësve duhet dhënë kohë e mjaftueshme për zgjidhjen e problemeve dhe detyrave të ndryshme.
- Mesimdhënësit duhet të mundohen të funksionalizojnë sa më shumë trekëndëshin bashkëpunues: Mësues-nxënës-prindër.

Shtojca

PYETESORI I PARË

Nxënës të dashur, kam përgatitur për ju një pyetësor. Nuk keni nevojë të shënoni emrin, andaj ju lutem të jeni sa më të sigurtë.

1) Lëndën e matematikës e dua

- a) sa lëndët tjera
- b) më shumë se lëndët tjera
- c) më pak se lëndët tjera

2) Matematika është vështirë

- a) ndonjëherë
- b) gjithmonë
- c) asnjëherë

3) Detyrat e matematikës i kryej vetë

- a) gjithmonë
- b) ndonjëherë
- c) asnjëherë

4) Detyrat e matematikës i kuptoj

- a) gjithmonë
- b) ndonjëherë
- c) asnjëherë

Ju faliminderit shumë për sinqeritetin tuaj.

PYETËSORI I DYTË

Nxënës të dashur kam përgatitur për ju edhe një pyetësor për të parë se sa ju ka pëlqyer dhe ndihmuar mënyra e re e mësimit të matematikës. Nuk keni nevojë të shënoni emrin dhe mbiemrin andaj ju lutem që të përgjigjeni sa më sinqerisht.

1) A ju pëlqen mënyra e re e mësimit të matematikës

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

2) A i kuptoni më lehtë problemet matematikore

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

3) A ju pëlqen pamja e klasës tani

- a) Shumë
- b) Pak
- c) Aspak

Ju faliminderit shumë për sinqeritetin tuaj.

Intervista me prindër

- 1) A mendoni se fëmijet tuaj e pelqejnë matematiken, a i kryejnë detyrat me përtesë?
- 2) A është e nevojshme shpesh t'i ndihmoni ata në kryerjen e detyrave të shtëpisë?
- 3) A mendoni se detyrat janë të vështira?

PËRPILIMI I ORARIT TË PUNËS SË NXËNËSVE NË SHTËPI

Edi Gaxha Puka
edi-puka@hotmail.com

Përmbledhje

Në këtë punim, lidhur me çështjen e përpilimit të orarit të punës së nxënësve në shtëpi është shfrytëzuar metodologjia e hulumtimit në veprim.

Përmes aktiviteteve të planifikuara jam munduar të ndikoj në krijimin e shprehisë së punës me orar dhe mësimin sistematik.

Në përcaktimin e aktiviteteve vepruese në planin tim të veprimit jam bazuar në rezultatet e fituara nga të dhënat paraprake të cilat i kam nxjerrë përmes marrëveshjes, intervistës me nxënës dhe pyetësorit me prindër, gjithashtu jam mbështetur në studime të ndryshme lidhur me përpilimin e orarit të punës: ditor, javor dhe mujor.

Të përfshirë në këtë hulumtim janë 30 nxënës të klasës së dytë, paralelja II/2 të shkollës nëntëvjeçare "Zekeria Rexha" në Gjakovë.

Përfundimet e këtij hulumtimi tregojnë se nxënësit mund të punojnë me orar dhe të mësojnë në mënyrë sistematike, por duhet një angazhim më i madh i prindërve.

Përveç kësaj mësimdhënësit duhet të bashkëpunojnë me prindërit në mënyrë që të jetë puna me orar sa më atraktive.

Hulumtimi është realizuar në një periudhë 5 javore, prej datës 15.10.2012 – 17.11.2012

Fjalët kyçe: hulumtimi në veprim, orari, shprehia e punës, vetdisiplina.

Hyrje

Një ndër problemet më të shpeshta për të cilin brengosen prindërit dhe mësimdhënësit është mungesa e shprehisë së punës tek nxënësit.

Shprehia është aftësi për të bërë shpejt e mirë diçka të cilën e fitojmë duke ushtruar e stërvitur vazhdimisht apo duke punuar.

Shprehia është mënyrë veprimi apo sjellje që na bëhet zakon dhe që e kryejmë vetvetiu, pas një përsëritjeje apo stërvitjeje të gjatë ose të vijueshme (DYLA.B fq 371 2010).

Mësimi është punë serioze që kërkon durim, përqendrim dhe përpjekje. Mësimi kërkon zotërimin dhe koordinimin e shumë impulseve në mënyrë që të arrihet një qëllim i caktuar. Kështu, kushdo që mëson duhet individualisht të bëjë përpjekje për të nxënë. Kuptohet, nxënësit fillimisht

nuk janë plotësisht të vetëdijshëm dhe për këtë arsye është e nevojshme që sa më shumë t'u ndihmojmë në mënyrë që të marrin shprehinë e të mësuarit me orar. Në këtë drejtim, më së miri do t'i mësojnë mësuesit me njohuritë dhe autoritetin e tyre.

Disiplina e punës fitohet duke mësuar çdo ditë dhe me orar.

Përveç orarit shkollor është mirë të punohet edhe orari individual i mësimit. Ky orar përmban kohën kur nxënësi në shtëpi punon detyrat, lexon, përsërit dhe kontrollon diturinë e tij. Kështu që orari mundëson planifikimin e punës çdo ditë, dhe për një periudhë më të gjatë kohore. Sa orë duhet planifikuar për mësim individual e përcakton nxënësi në bazë të nevojës së tij. Të mësuarit e përditshëm dhe orari i obligimeve ditore krijojnë ndjenjën e vetdisiplinës të nxënësit. Njohja e obligimeve të tyre dhe mundësitë për të kontrolluar kryerjen e këtyre obligimeve krijojnë shprehje të punës të nxënësit. Detyra ime profesionale, si mësimdhënëse është të veproj rreth kësaj çështjeje me shumë përkushtim dhe kujdes. Duke qenë çdo ditë pranë fëmijëve vërej pasojat të cilat i sjell mungesa e shprehisë së punës.

Si të nxisim interesim të natyrshëm te fëmijët që të mësojnë në shtëpi sistematikisht dhe me orar të caktuar? Si të krijojmë te nxënësit vetdisiplinën? Sa mund të bashkëpunojmë me prindërit për t'i avancuar fëmijët në këtë drejtim?

Çfarë kushte duhet t'u sigurojmë fëmijëve që të mësojnë vazhdimisht dhe me produktivitet?

Janë këto disa pyetje që shprehin shqetësimin tim si mësimdhënëse dhe më nxisin të realizoj këtë punim.

Pasi shqyrtova me kujdes literaturën e vendeve të ndryshme, vendosa ta realizoj këtë hulumtim.

Përmes këtij hulumtimi në veprim synoj të gjej e vlerësoj mënyrat dhe aktivitetet e ndryshme të cilat motivojnë nxënësit të punojnë me plan dhe të krijojnë shprehje të punës.

Shqyrtimi i literaturës

Studiues të ndryshëm kanë realizuar punime të ndryshme lidhur me rolin e orarit të punës së fëmijëve në shtëpi dhe mënyrat e motivimit të nxënësve në këtë drejtim.

Në fillim është e rëndësishme të krijojmë vullnetin për mësim dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë çdo ditë. Zakonisht mësimi është punë në të cilën është vështirë të shohim fillimin dhe fundin e saj. Rezultati i punës mbetet diku në ne dhe nuk dimë se kur do të zbulohet. Shprehja e mësimit përforcohet prej ditës në ditë dhe bëhet e nevojshme.

Vetdisiplina lehtëson vullnetin për punë dhe krijon kënaqësi prej së cilës arrihen synime të reja. (Kuka M.fq.122)

Orarin e mësimit në shkollë, mësimit në shtëpi dhe orarin e aktiviteteve jashtëshkollore është mirë t'i shkruajmë dhe t'i vendosim në një vend të dukshëm.

Në këtë orar është mirë të shënojmë planin e punës për periudha të shkurta dhe të gjata kohore.

Aktivitetet e kryera duhen të ngjyrosen ose të tregohen me shenja në orar.

Planifikimi i procesit të punës nuk do të zhvillojë vetëm shprehitë e mësimit por edhe punën në përgjithësi. Ky është shumë i rëndësishëm për punë individuale (të pavarura).

Kur të tjerët na përpilojnë orarin e punës ne duhet t'u bindemi ndërsa kur e bëjmë orarin vet, atëherë obligimet dalin nga motivet tona dhe zakonisht na përgjigjet më shumë dhe jemi më përgjegjës. Orari bëhet shprehi dhe nevojë edhe atëherë kur nuk na kontrollojnë të tjerët. Kështu krijojmë në vete një ndjenjë të sigurisë se do të punojmë deri në arritjen e synimeve edhe atëherë kur orari varet vetëm nga ne.

Studentët e kanë neveri planifikimin individual të mësimit nëse këtë shprehi nuk e kanë arritur që nga dita e parë e shkollës.

Kur flasim për organizimin e mësimit, mendojmë në mësimin sistematik d.m.th shprehia e punës në sistem të rregullt.

Elementi i parë i këtij sistemi është të dimë: Çfarë do të mësojmë, kur do të mësojmë dhe si do të mësojmë?

Mësimi me ndërprerje quhet mësim josistematik, p.sh kur një ditë mësojmë pasdite, më pas një ditë s'i hapim librat fare, kryejmë detyrat e shtëpisë në shkollë, pastaj tri ditë mësojmë vetëm matematikë ose ngjashëm.

Shprehia e të mësuarit sistematik arrihet gradualisht.

Planifikimi dhe organizimi i planit

Ndonjëherë të duket dita e shkurtër për të gjitha ato që ke planifikuar t'i mësosh dhe a do të ishte mirë të ishte më e gjatë?

Sa më gjatë? A mendoni se aty është problemi?

E vërteta është kjo: Dita zgjatë 24 orë dhe kjo duhet të jetë e mjaftueshme për të gjitha aktivitetet tona nëse jemi mjaft të kujdesshëm dhe dimë ta organizojmë. Duhet të bësh planin e mësimit:

- Planin mujor
- Planin javor
- Planin ditor

Plani ditor dhe javor

Së pari shkruaj të gjitha aktivitetet e përditshme (orët e shkollës, orët e shkollës së muzikës ose kurset tjera).

Më pas lër kohë për detyra të shtëpisë dhe mësim.

Shkruaj aktivitetet ditore (shujtat, kohën e gjumit, angazhimet ditore).

Shkruaj kohën e lirë (TV, PC, loja, pushimi).

Sado që të planifikosh mirë, do të harrosh nëse nuk e përsëritë. Bëje një marrëveshje me veten tënde .

Unë

Bëj këtë marrëveshje me veten time, përmes së cilës këtë vit shkollor do të:

1. Përpiloj planin e punës: ditor, javor dhe mujor
2. Mbaj rregullin e vendit tim të punës
3. Bëj të gjitha përpjekjet që me kohë të arrij në mësim
4. Vazhdoj të ndërtoj dhe të mbaj raporte të mira me njerëzit rreth meje
5. Në fund të gjysmëvjetorit do të kem rezultat të

6. Në fund të vitit do të kem rezultat të

7. Përcjell përparimin tim në mënyrë të vazhdueshme dhe përfill rregullat e klasës

Nënshkrimi

Si të krijoni shprehinë pozitive të punës te fëmijët

Sigurisht me shprehinë punës nuk lindim, kjo është pjesë e procesit të zhvillimit që përvetësohet gjatë jetës. Këto shprehje kanë ndikim të madh në jetën e çdo njeriu.

Shumë dijetarë të suksesshëm, artistë, sportistë pranojnë se rezultatet jetësore i kanë arritur së pari me punë të palodhur e pak nga faktorët tjerë (talenti, aftësitë intelektuale, predispozitat trupore...)

Kështu del se përfitimi me kohë i shprehisë së punës shpie te suksesi i fëmijëve në të ardhmen. Me fillimin e shkollimit të fëmijëve në familje ndodhin ndryshime së pari të karakterit organizativ. Ka fëmijë që mëson lehtë dhe me ta nuk duhet të veprojmë veçanërisht. Fëmija interesuar për matematikë mund t'i zgjidh detyrat me orë të tëra sepse për të është argëtuese. Për këta fëmijë themi se e kanë të zhvilluar motivimin e brendshëm. Megjithatë ka fëmijë të cilët për aktivitetet shkollore nuk kanë interes të natyrshëm dhe i kryejnë këto vetëm pse duhen, frikësohen nga dënimet, e dinë se do ti zhgënjëjnë prindërit. Ka edhe prej tyre të cilët janë plotësisht të pa interesuar dhe me vështirësi punojnë edhe nën ndikimin e falënderimeve dhe shpërblimeve.

Këto janë situata të vështira për prindërit dhe fëmijët. Prindërit vazhdimisht duhet t'u kujtojnë fëmijëve obligimet shkollore të cilat për ta janë parësore. Për këtë arsye është rëndësishme që herët t'i motivojmë fëmijët për punë të vazhdueshme dhe qëndrim aktiv në zgjidhjen e obligimeve shkollore.

Që fëmijët të mësojnë vazhdimisht dhe me produktivitet është e rëndësishme që të rriturit t'u sigurojnë kushte optimale për mësim. Ato më shumë varen nga përkrahja prindërore se nga situata materiale e prindërve.

“ Shembulli i mirë është mësuesi më i mirë.” (Banda,V.2009)

1. Më e rëndësishmja është përkrahja pozitive e prindërve

Edhe pse organizimi i mësimit është i vështirë në rastet e kushteve të vështira financiare prapë se prapë brenga e prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve është më e rëndësishmja.

2. Orari ditor i punës

Fëmija duhet dhe dëshiron të dijë kur është koha e ushqimit, mësimit, lojës, gjumit etj. Orari i shtëpisë duhet të jetë rezultat i marrëveshjes së përbashkët në mes prindit dhe fëmijës. Kur të mësojnë? Kjo varet nga ndërrimi në të cilin mëson fëmija. Më e rëndësishme është pyetja: Çka do të mësojë, cilën ditë? A janë ato lëndët që fëmija i ka atë ditë në shkollë apo lëndët që i ka të nesërmen me orar? Të gjithë autorët pajtohen se fëmijët duhet t'i mësojnë lëndët që kanë pasur atë ditë në shkollë.

Detyrat e shtëpisë janë një punë e përgjegjshme dhe e rëndësishme e secilit nxënës të cilat duhet kryer rregullisht. Interesimi i prindërve për detyrat e shtëpisë ndikon në stimulimin e fëmijës. Fëmijës i duhen këshillat dhe biseda e prindërve. Është gabim t'i shkruani detyrat në vend të fëmijës! Asgjë mos punoni në vend të fëmijës! Jepni shpjegime, tregoni detyrë të ngjashme por detyrat duhet t'i bëjë fëmija vet me ndihmën tonë.

3. Vendi i njëjtë i mësimit

Nuk ka nevojë të jetë dhomë e veçantë, mund të jetë tavolinë apo pjesë e tavolinës në hapësirë të përbashkët. Karriga në të cilën fëmija mëson gjithsesi duhet të ketë mbështetëse për shpinë.

4. Ndriçimi i rregullt

Drita gjithmonë duhet të vijë nga ana e majtë e fëmijës (kjo vlen edhe për dritën e diellit dhe ndriçimin e llambës).

5. Ndihmoni fëmijën të ketë plan të mësimit

Të planifikojë çdo ditë sa kohë i nevojitet për një etapë të mësimit. Plani duhet të vendoset në vend të dukshëm, duhet të shihet a i është përmbajt fëmija. Fëmija duhet të nxitet për mësim të rregullt çdo ditë. Mësimi më i suksesshëm është në kohë të caktuar. Më efektive është të mësohet çdo ditë nga një orë se sa çdo të tretën ditë tri orë. Nëse për një ditë mëson disa lëndë duhet të fillosh nga ato të vështirat dhe që kemi më pak interesim.

6. Mësojuni fëmijëve taktikat e mësimit aktiv

Puno strukturën e mësimit pas leximit të parë. Mësoni fëmijën të mësojë me laps e fletore. Parashtroni pyetje që fëmijët të mësojnë me kuptim dhe më të rëndësishmet.

7. Mësimi nuk është gjithnjë aktivitet i dëshirueshëm

Mundësoju fëmijëve pushim pas çdo etape të mësimit për të cilin jeni marrë vesh së bashku. Mund të jetë ndonjë imtësinë që i jep disponim -kockë çokollate, gotë e lëngut, lojë e kompjuterit, film vizatimor etj. Kështu që periudha e mësimit do të jetë efikase sepse fëmija do të mësojë me dëshirë duke e pritur pushimin.

8. Respektoni lodhjen e fëmijës

Një ditë në javë mundësoni pushim me aktivitete. Sipas mundësisë organizoni vikend të përbashkët.

“Zbatimi i përpiktë i regjimit ditor ndikon në formimin e shprehive dhe zakoneve të mira, në kalitjen e vullnetit, në shfrytëzimin në mënyrë të arsyeshme të kohës, në rritjen e rendimentit të punës dhe si rrjedhim, edhe në zhvillimin normal fizik dhe mendor të fëmijës.” (Kraja,M. 2006, f.427)

“Përpigu të formosh shprehi të mira në moshën e re dhe jeta juaj do të jetë më e lehtë, më këndëshme dhe më e suksesshme.” Është një përfundim i qartë dhe shumë domethënës marrë nga Eric T. Mac Knight – Good habits, good students.

METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij punimi është hulumtimi në veprim. Për mbledhjen e të dhënave janë shfrytëzuar teknika të ndryshme: intervistat me nxënës, pyetësorët me prindër, listat e kontrollit si dhe mbajtja e shënimeve.

HULUMTIMI NË VEPRIM

“Hulumtimi veprues është hulumtim nëpërmjet veprimit. Ai zakonisht është një aktivitet bashkëpunues- që në të shumtën e rasteve përfshin të dhënat nga ata që ndikohen drejtpërdrejt nga hulumtimi. Hulumtimi veprues është një mënyrë e re e të menduarit dhe një formë e re e teorisë” Vula,E. 2010, f.7).

Kjo teori paraqet një pjesë të punës së përditshme të individëve dhe si e tillë transformohet në mënyrë të vazhdueshme me qëllim të ‘zbulimit’ dhe ‘gjetjes’ së rrugëve të reja të përmirësimit dhe ndryshimit. Kërkesa për të përmirësuar dhe për të kuptuar botën duke e ndryshuar atë, është një nxitje për një hulumtim i cili mësohet si të ndryshojmë praktikën tona dhe ndikimet e këtyre ndryshimeve. Si parim bazë mbështetet në studimin e veprimit që përfshin identifikimin e një çështjeje problematike, duke menduar një zgjidhje të mundshme, duke e provuar atë dhe duke e vlerësuar funksionimin në drejtim të përmirësimit të praktikës.

Hulumtimi në veprim filloi në SHBA në vitin 1946 përmes punës së Kurt Lewin, shkencëtar social. Kurt Lewin e definoi hulumtimin si një proces ciklik. Nëpërmjet cikleve të planifikimit, veprimit, vëzhgimit dhe reflektimit, pjesëmarrësit e këtij procesi marrin vendimet për ndryshimet me qëllim të përmirësimit të praktikave jetësore.

Hulumtimet në veprim sot luajnë një rol shumë të rëndësishëm për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve nga vet mësimdhënësit apo nga një grup i mësimdhënësve dhe studimin e çështjeve që ndihmojnë proceset e transformimit për përmirësimin e shkollës në përgjithësi.

Qëllimi dhe pyetja e hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është gjetja e mënyrave dhe aktiviteteve të ndryshme të cilat do të ndikojnë në vetëdijësimin e nxënësve për krijimin e shprehisë së punës.

Pyetja e hulumtimit është: *Si ndikon përpilimi i orarit në krijimin e shprehisë së punës ?*

Konteksti i shkollës dhe pjesëmarrësit

Hulumtimi në veprim është zhvilluar në paralelen II/2 të shkollës nëntëvjeçare “Zekeria Rexha” në Gjakovë. Në këtë paralele vijnë mësimin 30 nxënës (12 vajza dhe 18 djem).

Planifikimi i hulumtimit

Fillimisht, për të realizuar këtë punim kam realizuar intervistën me nxënës dhe mbledhjen me prindër. Gjatë intervistës me nxënës qëllimi im ka qenë të kuptoj nëse nxënësit kanë përpiluar orar të punës në shtëpi dhe a do të dëshironin të kenë një të tillë për organizimin përgjegjësive të tyre. Kurse nga mbledhja me prindër kam pasur qëllim të kuptoj se sa e kanë fëmijët kohën e organizuar në shtëpi dhe interesimin e prindërve për bashkëpunim në këtë drejtim.

Rezultatet e fituara nga intervista me nxënës dhe mbledhja me prindër kanë ndikuar në realizimin e planit tim të parë të veprimit. Ky plan është bazuar në interesat e nxënësve për përpilimin e orarit të punës së tyre në shtëpi. Nxënësve duhet t’u jepet mundësia të organizojnë kohën e tyre dhe të paraqesin interesat e tyre në këtë drejtim.

“Rutinat e përditshme si shkuarja në shkollë, ushqimi i rregullt dhe orari i rregullt i gjumit i ofrojnë fëmijës ndjenjën e sigurisë dhe të qëndrueshmërisë.” (Fakte për jetë. 2002, f.140) Më pas kam vazhduar me aktivitetin e dytë veprues, pas të cilit kam realizuar pyetësor me prindër dhe kam analizuar të dhënat. Realizimi i aktivitetit të tretë veprues ka pasur karakter vëzhgues duke i analizuar shënimet personale dhe oraret.

Për të vërtetuar validitetin e këtij hulumtimi është shfrytëzuar procesi i trekëndëzimit. “Procesi i triangulacionit mundëson që në kontrollimin e të dhënave dhe në shkëmbim e mendimeve të përfshihen të gjithë”. (Vula, E.2010, fq.48) Miket kritike të hulumtimit tim në veprim ishin kolegja Diana Çarkaxhiu dhe studentja Edona Gërçari.

PLANI I VEPRIMIT

Plani I

Marrëveshja e nxënësve dhe përpilimi i orarit rrethor

Sipas planit 1 aktiviteti i parë ka qenë plotësimi marrëveshjes nga ana e nxënësve. Secili nxënës ka lexuar fillimisht marrëveshjen dhe më pas ka shkruar pritshmërinë e tij për të ardhmen.

Gjatë kohës kur nxënësit kanë nënshkruar marrëveshjen, i kam vëzhguar dhe kam vërejtur se pritshmëritë e tyre për suksesin në fund të vitit janë të afërta me arritjet e tyre.



Fig.1. Plotësimi i marrëveshjes



Fig.2. Futja e marrëveshjes në kuti

Aktiviteti i dytë ka qenë përpilimi i orarit rrethor në shtëpi. Të gjithë autorët mendojnë se orari i punës së fëmijëve në shtëpi duhet të plotësohet nga ana e nxënësit me prindërit.




Fig.3. Orari rrethor i plotësuar drejt




Fig.4. Orari rrethor i plotësuar jo drejt

Plani II

Përpilimi i orarit javor

Duhet kohë që të nxënësit të krijohet shprehja dhe të mos ketë nevojë për ndërhyrjen e prindërve në regjimin e tyre ditor. Kështu, duke analizuar mendimet e prindërve në pyetësor erdha në përfundim se në planin 2 duhet të përpiloj një orar të ri ku do të jenë të shënuara ditët

e javës, rubrika për kontroll nga ana e prindërve dhe çelësi (aktivitetet e kryera ngjyrosen ndërsa të pakryerat mbesin pa ngjyrë).



Fig.5. Mbledhja me prindër dhe nxënës



Fig.6. Përpilimi i orarit mësimor

Pas një jave, mblodha oraret e nxënësve dhe nuk isha plotësisht e kënaqur. Nxënësit kishin ngjyrosur aktivitetet/përgjegjësitë me ngjyra të llojlojshme dhe shumica nuk kishin bërë asnjë aktivitet të pakryer (kishin ngjyrosur të gjitha) gjë që është e pamundur.

Organizova një mbledhje me prindër e nxënës dhe kërkova bashkëpunim të mëtutjeshëm sepse na duhet kohë për krijimin e shprehisë së punës me orar. U dakordua me prindërit se do të punojmë në mënyrë sa më objektive dhe se në oraret e ri do të llogarisim së paku: një orë e gjysmë për detyra të shtëpisë, një orë lexim dhe një orë aktivitete (vizatim, punëdore etj).

Orari ditë

- Aktiviteti nuk është kryer - Aktiviteti është kryer

| Aktiviteti/Përgjegjësi | Koha | Martë | Mërkurë | E enjte | Premitë | Enjtuna | E diele |
|------------------------|---------------|-------|---------|---------|---------|---------|---------|
| ... | 7:00 - 7:30 | | | | | | |
| ... | 7:30 - 8:00 | | | | | | |
| ... | 8:30 - 9:00 | | | | | | |
| ... | 9:00 - 9:30 | | | | | | |
| ... | 9:30 - 10:00 | | | | | | |
| ... | 10:00 - 10:30 | | | | | | |
| ... | 10:30 - 11:00 | | | | | | |
| ... | 11:00 - 11:30 | | | | | | |
| ... | 11:30 - 12:00 | | | | | | |
| ... | 12:00 - 13:00 | | | | | | |
| ... | 13:00 - 14:00 | | | | | | |
| ... | 14:00 - 15:00 | | | | | | |
| ... | 15:00 - 16:00 | | | | | | |
| ... | 16:00 - 17:00 | | | | | | |
| ... | 17:00 - 17:30 | | | | | | |
| ... | 17:30 - 18:00 | | | | | | |
| ... | 18:00 - 18:30 | | | | | | |
| ... | 18:30 - 19:00 | | | | | | |
| ... | 19:00 - 19:30 | | | | | | |
| ... | 19:30 - 20:00 | | | | | | |
| ... | 20:00 - 20:30 | | | | | | |
| ... | 20:30 - 21:00 | | | | | | |

Nënshkrimi i prindit: _____

Data: _____

Nëntori, 2012

Fig.7. Orari javor

Vendosëm së bashku me nxënësit për ngjyrat me të cilat do t'i ngjyrosim aktivitetet:

me ngjyrë të kuqe – kohën në shkollë,

me ngjyrë të verdhë – rutinat,

me ngjyrë të kaltër – aktivitetet sportive,

me ngjyrë portokalli – detyrat e shtëpisë, leximin, vizatimin, punëdore,

me ngjyrë të gjelbër – shujtat, dhe

me ngjyrë vjollce – kohën e lirë.

Plani III

Puna me orarin javor të modifikuar

Nxënësit mbajtën oraret në shtëpi prej datës 12-18 nëntor. Ishte kënaqësi ta shikoj punën e tyre. Në orarin e fëmijëve nuk ishin ngjyrosur hapësirat kur nuk kanë kryer aktivitetet, në disa vende prindërit kishin shkruar shkakun e moskryerjes. Aktivitetet ishin ngjyrosur me ngjyra të njëjta dhe të gjithë nxënësit kishin sjellë oraret (gjë që nuk ndodhi në javët e para).

| Çelësi: <input type="checkbox"/> - Aktiviteti nuk është kryer | | <input checked="" type="checkbox"/> - Aktiviteti është kryer | | Autore: Edi Puka | | | | | | |
|---|-------------|--|---------|------------------|---------|----------|----------|---------|--|--|
| Orari ditor | | | | | | | | | | |
| Aktivitetet/Përgjegjësitë | Koha | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte | E shtune | E diele | | |
| | 7:00-7:30 | | | | | | | | | |
| | 7:30-8:00 | | | | | | | | | |
| | 8:00-8:30 | | | | | | | | | |
| | 8:30-9:00 | | | | | | | | | |
| | 9:00-9:30 | | | | | | | | | |
| | 9:30-10:00 | | | | | | | | | |
| | 10:00-10:30 | | | | | | | | | |
| | 10:30-11:00 | | | | | | | | | |
| | 11:00-11:30 | | | | | | | | | |
| | 11:30-12:00 | | | | | | | | | |
| | 12:00-16:00 | | | | | | | | | |
| | 16:00-16:30 | | | | | | | | | |
| | 16:30-17:00 | | | | | | | | | |
| | 17:00-17:30 | | | | | | | | | |
| | 17:30-18:00 | | | | | | | | | |
| | 18:00-18:30 | | | | | | | | | |

Fig.8. Orari javor i modifikuar

Pas diskutimit me nxënës, vërejta se përpilimi i orarit ka filluar të fitojë rëndësinë e duhur dhe të respektohet nga ana e tyre. Do të vazhdojmë edhe më tutje të punojmë në këtë drejtim së bashku me prindërit dhe do mundohemi të krijojmë shprehinë e punës me orar te fëmijët.


Analiza e të dhënave dhe rezultatet

Punimin hulumtues e fillova me realizimin e një interviste me nxënës. Në bazë të rezultateve të fituara përmes përgjigjeve të dhëna nga nxënësit nuk kanë përpiluar orar të punës në shtëpi. Shumica e nxënësve mendonin se orari ditor përmban vetëm kohën e mësimet. Pas diskutimit pashë interesim të madh tek të gjithë nxënësit që të punojmë së bashku rreth përpilimit të orarit. Më pas realizova një pyetësor me prindër. Të dhënat e fituara nga pyetësori bënë të kuptoj se orarin e pranojnë si të suksesshëm në përjashtim të disa modifikimeve të nevojshme.

REZULTATET:


1. A e mendoni të suksesshëm përpilimin e orarit të punës për fëmijën e tyre?

Në pyetjen se a e mendojnë të suksesshëm përpilimin e orarit të punës për fëmijët e tyre, 24 prindër kanë deklaruar *shumë* dhe 6 prindër *pak*. Nga këto të dhëna kuptoj se përpilimi i orarit ka filluar të gjejë vendin e vet në familjet e nxënësve.




2. Sa i është përmbytur fëmija juaj orarit të punës gjatë këtyre dy javëve?

Në pyetjense sa i është përmbytur fëmija orarit të punës gjatë këtyre dy javëve, 7 prindër kanë deklaruar se fëmijët i janë përmbytur *maksimalisht* dhe 23 prindër janë deklaruar për opcionin e dytë *mesatarisht*. Nga këto rezultate kuptova se kemi edhe shumë punë për të bërë.




3. Afërsisht sa ka qenë koha që e kanë kaluar duke kryer detyra të shtëpisë?

Në pyetjen se sa ka qenë koha që kanë kaluar duke kryer detyra të shtëpisë, 5 prindër kanë deklaruar se fëmijët kalojnë 1 orë duke punuar detyrat e shtëpisë, 17 prindër deklarojnë 1 orë e gjysmë dhe 8 prindër më shumë. Në kohën e kryerjes së detyrave rezultatet janë të kënaqshme sepse të gjithë nxënësit nuk mund t'i kryejnë detyrat në kohë të njëjtë. Kjo kohë varet nga shumë faktorë.




4. Sa kohë ka lexuar lektyrë gjatë ditës fëmija juaj?

Në pyetjen se sa kohë ka lexuar lektyrë gjatë ditës fëmija juaj 21 prindër janë deklaruar një gjysmë ore, 7 prindër 1 orë dhe 2 prindër më shumë. Nga këto rezultate shoh se duhet të reagoj në planin e dytë dhe të kërkoj nga prindërit që koha e leximit të jetë së paku një orë. Duke marrë parasysh se klasa e dytë është koha kur fëmijët duhet të krijojnë shprehinë e leximit me kuptim.




5. A shpreh interesim fëmija juaj të merret me aktivitete? (art fig.,punëdore,edukatë fizike....)

Në pyetjen se a shpreh interesim fëmija juaj të merret me aktivitete, 16 prindër janë deklaruar *maksimalisht* dhe 14 prindër *mesatarisht*. Aktivitetet në të cilat fëmijët kanë më shumë interesim janë nga: edukata fizike, punëdore, edukata figurative etj.




6. Sa ka ndikuar në kohën e zgjimit, kryerjen rutinave të mëngjesit dhe fjetjen në kohën e caktuar orari?

Në pyetjen se sa ka ndikuar në kohën e zgjimit, kryerjen e rutinave të mëngjesit dhe fjetjen në kohën e caktuar orari 16 prindër janë deklaruar *shumë*, 11 janë deklaruar pak dhe 3 janë deklaruar *fare*. Të krijohet shprehia e punës duhet të kemi durim dhe përpjekje të vazhdueshme. “ Bashkëpunimi im me prindërit në këtë drejtim ishte shumë pozitiv. Përfshirja e prindërve si partner u sjell dobi fëmijëve, familjes, mësuesve dhe tërë komunitetit.” (Miller.B,2005.f.6)




7. Cfarë do të ndryshonit në përpilimin e orarit të ri?

Në pyetjen se *çfarë do të ndryshonit në përpilimin e orarit të ri*, 12 prindër janë deklaruar se nuk do të ndryshonin *asgjë*, 8 prindër kanë deklaruar se *është në rregull*, 6 prindër kanë deklaruar *të precizojë mësuësja kohën për aktivitete* dhe 4 prindër *kohën e zgjimit*. Është mirë që koha e aktiviteteve të caktohet nga vetë fëmijët si kërkesë e nevojës së tyre. Mund të reagoj në caktimin e kohës minimale për punë: 1 orë e gjysmë detyra të shtëpisë, 1 orë aktivitete dhe 1 orë lexim. Secila familje ka orarin specifik që varet nga shumë faktorë siç janë: orari i punës së prindërve, koha e shujtave etj.



8. Cili është mendimi juaj për punën e përbashkët në të ardhmen në këtë drejtim?

Në pyetjen se *cili është mendimi juaj për punën e përbashkët në të ardhmen në këtë drejtim*, një numër i madh i prindërve kanë deklaruar se përpilimi i orarit është një punë e shkëlqyer, e dobishme për fëmijën dhe të gjithë në përgjithësi sepse ndikon në krijimin e shprehive të punës dhe koordinimin e ditës. Nga këto deklarata të prindërve jam motivuar të vazhdoj të punoj në këtë drejtim në gjetjen e formave të reja që do të krijojnë shprehinë e punës tek nxënësit e mi.



DISKUTIMET

Ky hulumtim më shtyri të mendoj se ka ende vend për rritjen e përgjegjsive të prindërve në klasë dhe duhet punuar prapë që prindërit të jenë aleat të pandashëm në klasat tona. Nga hulumtimi në veprim erdha në përfundim se njohja e obligimeve dhe mundësitë për të kontrolluar kryerjen e tyre krijon shprehi të punës te nxënësi. Një faktor tjetër që ka rezultat nga hulumtimi është edhe krijimi i disiplinës së punës. “Disiplina e punës krijohet duke mësuar çdo ditë dhe me orar.” (Kuka.M,2005.f.97)

“Përpiqu të formosh shprehi të mira në moshën e re dhe jeta juaj do të jetë më e lehtë, më këndshme dhe më e suksesshme.” Është një përfundim i qartë dhe shumë domethënës marrë nga Eric T. Mac Knight – Good habits, good students.

Disa rekomandime

1. Mësimdhënësit duhet të zgjedhin forma të përshtatshme për krijimin e shprehisë së punës te nxënësit.
2. Fillimi i vitit të ri shkollor është koha e përkryer për të bërë takime me nxënës dhe prindër ku do të diskutojmë pritjet për vitin e ri shkollor dhe përpilimin e orarit të punës.
3. Të inkurajojmë fëmijët që të jenë të përgjegjshëm për moshën përkatëse , të jenë të pavarur në kryerjen e detyrave
4. Përpilimi i orarit të punës duhet të bëhet nga nxënësi sepse është mirë që obligimet të dalin nga motivet e tyre.
5. Gjatë përpilimit të orarit mësimor të nxënësve bëjmë korrelacion të fushave të ndryshme (gjuhë, matematikë, shëndeti dhe mirëqenie, arte etj)

Kufizimet

Mendoj se kufizimi për këtë punim mund të jetë mosangazhimi i prindërve dhe mësimdhënësve për mësimin sistematik të fëmijës dhe mospërfshirja e organizimit të ditës në plan-programin mësimor.

LITERATURA

Kraja,M.(2006). *Pedagogjia*, Tiranë

Miller,B.(2005). *Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit*, Ferizaj QPEA

Dyla,B.(2010). *Struktura e elementeve mësimore*, UP

Vula,E.(2010). *Hulumtimi veprues*, UP

UNICEF.(2010). *Fakte për jetë*

Burimet nga interneti

<http://www.GoodHabitsGoodStudent.com/>

<http://www.pbskids.org/itsmylife>

<http://www.kuka-grosmeister.com/>

<http://www.ordinacija.hr/>

SHTOJCA

Unë

Bëj këtë marrëveshje me veten time, përmes së cilës këtë vit shkollor do të :

8. Përpiloj planin e punës: ditor, javor dhe mujor
 9. Mbaj rregullin e vendit tim të punës
 10. Bëj të gjitha përpjekjet që me kohë të arrij në mësim
 11. Vazhdoj të ndërtoj dhe të mbaj raporte të mira me njerëzit rreth meje
 12. Në fund të gjysmëvjetorit do të kem rezultat të
-

13. Në fund të vitit do të kem rezultat të
-

14. Përcjell përparimin tim në mënyrë të vazhdueshme dhe përfill rregullat e klasës.

Nënshkrimi

Udhëzues për prindër

Orari ditor do t'ju ndihmojë të planifikoni ditën e fëmijës suaj nga momenti kur zgjohen deri kur të shkojnë në shtrat.

Ju do të jeni në gjendje që të mbani kontroll se si do ta kalojnë kohën prej njëres orë në tjetrën.

- ✓ Orari rrethor është i ndarë në 28 pjesë. Secila pjesë tregon gjysmë ore.
- ✓ Nëse fëmijët tuaj zgjohen në ora 7 :00 atëherë pjesa e parë paraqet orën 7:00-7:30.
- ✓ Bisedoni me fëmijën dhe shqyrtoni ditën tuaj. Bëni një listë me gjërat që fëmija juaj duhet të bëjë gjatë ditës.
- ✓ Kur filloni të shkruani filloni nga gjërat më specifike.
- ✓ Do të jetë mirë që detyrat e shtëpisë të punohen pasdite në mënyrë që fëmija të jetë i lirë në mbrëmje për darkë dhe gjumë.
- ✓ Jepni fëmijës kohë të lirë në mes të aktiviteteve.
- ✓ Nëse keni ndonjë ngjarje të rëndësishme, modifikojeni orarin por gjithsesi së bashku me fëmijën. Ju mund të shtoni orët e mësimit të nesërmen.
- ✓ Shënoni me ngjyra të ndryshme aktivitetet p.sh me të verdhë rutinën e mëngjesit, me të kuqe kohën e shkollës, me të kaltër aktivitetet sportive, me portokalli detyra e shtëpisë, leximin e tjera.

Mësuesja

Edi Puka

Pyetësor për prindër

1. A e mendoni të suksesshëm përpilimin e orarit të punës për fëmijën tuaj?

- a) shumë
- b) pak
- c) aspak

2. Sa i është përmbajtuar fëmija juaj orarit të punës gjatë këtyre dy javëve?

- a) maksimalisht
- b) mesatarisht
- c) aspak

3. Afërsisht, sa ka qenë koha që e kanë kaluar duke kryer detyra të shtëpisë?

- a) 1 orë
- b) 1 orë e gjysmë
- c) më shumë

4. Sa kohë ka lexuar lektyra gjatë ditës fëmija juaj?

- a) gjysmë ore
- b) 1 orë
- c) më shumë

5. A shpreh interesim fëmija juaj të merret me aktivitete? (art figurativ, punëdore, edukatë fizike

- a) maksimalisht
- b) mesatarisht
- c) aspak

(nëse po , sa kohë kalon dhe në cilën lëndë?)

6. Sa ka ndikuar në kohën e zgjimit, kryerjen e rutinave të mëngjesit dhe fjetjen në kohën e caktuar sipas orarit që keni bërë?

- a) shumë
- b) pak
- c) fare

7. Çfarë do të ndryshonit në përpilimin e orarit të ri?


8. Cili është mendimi juaj për punën e përbashkët në të ardhmen në këtë drejtim?

ORARI DITOR

SECILA PJESË E FIGURËS PARAQET 1/2 E ORËS

PËRFUNDIMI I DITËS
(KOHA E GJUMIT)

FILLIMI I DITËS
(ZGJIMI)



VLEN PREJ _____

DERI MË _____

Komenti i prindit

Çelësi



| ORARI JAVOR | | | | | | | | |
|----------------------------|---------------|--------|---------|-----------|---------|----------|----------|---------|
| Aktivitetet /Përgjegjësitë | Koha | E hënë | E martë | E mërkure | E enjte | E premte | E shtune | E diele |
| | 7:00- 7:30 | | | | | | | |
| | 7:30- 8:00 | | | | | | | |
| | 8:00 – 8:30 | | | | | | | |
| | 8:30 – 9:00 | | | | | | | |
| | 9:00 – 9:30 | | | | | | | |
| | 9:30 – 10:00 | | | | | | | |
| | 10:00- 10:30 | | | | | | | |
| | 10:30 -11:00 | | | | | | | |
| | 11:00 – 11:30 | | | | | | | |
| | 11:30 – 12:00 | | | | | | | |
| | 12 :00- 16:00 | | | | | | | |
| | 16:00-16:30 | | | | | | | |
| | 16:30- 17:00 | | | | | | | |
| | 17:00- 17-30 | | | | | | | |
| | 17:30- 18:00 | | | | | | | |
| | 18:00-18:30 | | | | | | | |
| | 18:30-19:00 | | | | | | | |
| | 19:00-19:30 | | | | | | | |
| | 19:30-20:00 | | | | | | | |
| | 20:00-20:30 | | | | | | | |
| | 20:30-21:00 | | | | | | | |
| Nënshkrimi i prindit | | | | | | | | |

Vlen prej _____

Deri më _____

Çelësi: Aktiviteti nuk është kryer

Aktiviteti është kryer

| ORARI JAVOR | | | | | | | | |
|----------------------------|---------------|--------|---------|-----------|---------|----------|----------|---------|
| Aktivitetet /Përgjegjësitë | Koha | E hënë | E martë | E mërkure | E enjte | E premte | E shtune | E diele |
| | 7:00- 7:30 | | | | | | | |
| | 7:30- 8:00 | | | | | | | |
| | 8:00 – 8:30 | | | | | | | |
| | 8:30 – 9:00 | | | | | | | |
| | 9:00 – 9:30 | | | | | | | |
| | 9:30 – 10:00 | | | | | | | |
| | 10:00- 10:30 | | | | | | | |
| | 10:30-11:00 | | | | | | | |
| | 11:00 – 11:30 | | | | | | | |
| | 11:30 – 12:00 | | | | | | | |
| | 12 :00- 16:00 | | | | | | | |
| | 16:00-16:30 | | | | | | | |
| | 16:30- 17:00 | | | | | | | |
| | 17:00- 17-30 | | | | | | | |
| | 17:30- 18:00 | | | | | | | |
| | 18:00-18:30 | | | | | | | |
| | 18:30-19:00 | | | | | | | |
| | 19:00-19:30 | | | | | | | |
| | 19:30-20:00 | | | | | | | |
| | 20:00-20:30 | | | | | | | |
| | 20:30-21:00 | | | | | | | |
| Nënshkrimi i prindit | | | | | | | | |

Vlen prej _____

Deri më _____

Ngjyrosni fushat me ngjyra të ndryshme varësisht nga aktivitetet / përgjegjësitë

Nëntor, 2012